

STATUTI ORGANIK I SHQIPËRISË**/Vlorë, 10 prill 1914/****Kapitulli I****Shqipëria dhe territori i saj**

1. Shqipëria formohet si një principatë kushtetuese, sovrane dhe e trashëgueshme nën garancinë e të gjashtë Fuqive të Mëdha.

2. Shqipëria është e pandashme, territori i saj është i patjetërsueshëm. Kufijtë e principatës janë ata që janë përcaktuar nga të gjashtë Fuqitë e Mëdha. Këta kufij nuk mund të ndryshohen apo të rektifikohen, veçse me anë të një ligji dhe me miratimin paraprak të gjashtë Fuqive të Mëdha.

3. Shqipëria është neutrale; neutraliteti i saj është i garantuar nga të gjashtë Fuqitë e Mëdha. Ky neutralitet nuk përjashton të drejtën e Shqipërisë për të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e territorit të saj. Megjithatë, porti tregtar ku do të dalë hekurudha ndërkombëtare që do të lidhë Serbinë me Adriatikun, do t'i nënshtrohet një regjimi të posaçëm, i cili do të përmbajë detyrimin që ky vend të mos fortifikohet.

4. Traktatet dhe konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të çfarëdo natyre qofshin, të lidhura midis Portës dhe fuqive të huaja, mbeten në fuqi në principatën e Shqipërisë. Ruajtja, ndryshimi ose heqja e imuniteteve dhe privilegjeve që u njihen të huajve në bazë të kapitulacioneve, i lihen një vendimi që mund të marrin të gjashtë Fuqitë e Mëdha.

5. Çdo person fizik apo juridik, qoftë i huaj, apo vendas mund të fitojë prona në Shqipëri, në përputhje me ligjet në fuqi dhe me ato që do të nxirren më vonë për këtë qëllim nga qeveria shqiptare.

Shteti shqiptar mund të ketë në dorë të blejë, të japë, të marrë me qira ose të shesë çdo lloj prone.

6. Pasuritë vakëf do të jenë objekt i rregullimit të një ligji të ri.

Kapitulli II

Sovrani

7. Froni i principatës shqiptare është i trashëgueshëm brenda në familjen e princit Vilhelm Vidi.

Trashëgimi bëhet në bazë të parimit të parëlindjes në vijën mashkullore.

8. Princi betohet para Asamblesë Kombëtare për të respektuar rreptësisht ligjet themeltare të shtetit.

9. Princi mbretërues, si kryetar i familjes princore, ka të drejtën ekskluzive të ushtrisë autoritetin e vet në çdo gjë që ka të bëjë me marrëdhëniet personale të anëtarëve të familjes së tij, duke iu përmbajtur ligjit që ai do të nxjerrë vetë për dinastinë e tij.

10. Atij i lidhet një listë civile vjetore.

11. Në rast mungese, sëmundje ose paaftësie të përkohshme, princi ka të drejtë të përfaqësohet ose nga një anëtar i familjes së tij që ka shtetësinë shqiptare ose nga një funksionar i lartë i shtetit. Në rast miturie ose paaftësie që zgjat më tepër se një vit, regjenca do të ushtrohet nga njeri prej anëtarëve meshkuj të familjes princore, nga ai që, përveçse ka arritur madhori dhe ka shtetësinë e vendit, del se është më i afërti përta i përket trashëgimit të fronit. Në rast mungese të një zëvendësuesi të tillë, detyra për të përcaktuar regjentin do t'i lihet Këshillit të Ministrave, i cili duhet të veprojë me pëlqimin e gjashtë Fuqive të Mëdha. Në rast urgjence, kryetari i Këshillit të Ministrave do të jetë ligjërisht regjent i përkohshëm. Regjenti do të gëzojë, derisa të zgjasë regjenca e tij, të gjitha të drejtat dhe kompetencat e sovranit përta i përket qeverisjes së vendit.

12. Mosha e madhorisë për anëtarët e familjes princore do të caktohet nga ligji i shtëpisë mbretëruese.

13. Pasuritë e kurorës, që do të jenë pronë ekskluzive e shtëpisë princërore, do të jenë të përjashtuara nga taksat.

14. Princi është kryetar i administratës civile dhe ushtarake; ai disponon forcën e armatosur dhe emëron oficerët e saj. Ai merr pjesë në bërjen e ligjeve sipas dispozitave të kapitullit IV; vendimet e tij, të nxjerra dhe të botuara rregullisht quhen “dekrete” dhe

duhet të kundërfirmohen nga Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe nga ministri kompetent.

15. Me propozimin e ministrave kompetentë, ai emëron funksionarë të lartë, por ai nuk mund të krijojë funksione të reja pa një ligj të posaçëm.

16. Ai thërret zgjedhësit për zgjedhjet e Asamblesë Kombëtare. Ai thërret, mbyll dhe shpërndan Asamblenë Kombëtare.

17. Drejtësia jepet në emër të tij; ai ka të drejtën e faljes dhe të amnistisë si dhe të drejtën ekskluzive për të dhënë çmime dhe tituj nderi.

18. Ai ka të drejtën të shtypë shëmbëlltyrën e tij ose stemën e tij në monedhat, në medaljet dhe në vulat shtetërore, si dhe në çdo send ose objekt që përfaqëson pushtetin qeveritar.

19. Ai përfundon traktate ndërkombëtare.

20. Personi i princit është i shenjtë. Ai nuk përgjigjet përpara ligjit.

21. Imunitetet e anëtarëve të familjes princore do të përcaktohen nga ligjet e ndryshme.

Kapitulli III

Popullsia

22. Janë shtetas shqiptarë të gjithë ata që kanë lindur ose që janë vendosur në Shqipëri përpara 28 nëntorit të 1912-s dhe që, nën qeverinë osmane kanë pasur nënshtetësinë osmane.

23. Personat, për të cilët bëhet fjalë në artikujt e mëparshëm, do të kenë mundësinë që brenda një afati prej gjashtë muajsh pas promulgimit të këtij statuti, të optojnë për një shtetësi të huaj, por me kusht që të emigrojnë.

24. Çdo person me prejardhje shqiptare që jeton jashtë vendit do të ketë mundësinë që, brenda një afati që do të caktohet nga qeveria, të konfirmojë shtetësinë e tij si shqiptar me anën e një deklaratë me shkrim që duhet t'i paraqesë një autoriteti kompetent.

25. Shqiptarët, që kanë ardhur nga viset të cilat u janë aneksuar shteteve ballkanike dhe që janë vendosur me banim në principatën e Shqipërisë pas 28 nëntorit 1912, do të

konsiderohen si shtetas shqiptarë; veçse në qoftë se ata nuk deklarojnë të kundërtën brenda gjashtë muajve që prej shpalljes së Statutit Organik.

26. Gjuha zyrtare e vendit është gjuha shqipe. Megjithatë, përdorimi i gjuhëve të tjera që fliten në vend, do të mund të lejohet, në trajtë ndihmëse dhe të përkohshme, në ato organe administrative që do të autorizohen posaçërisht për këtë nga qeveria.

27. Të gjithë shtetasit shqiptarë janë të barabartë përpara ligjit.

28. Asnjëri nuk mund të ushtrojë vetëgjyqësinë në çfarëdo forme qoftë, përndryshe do t'i nënshtrohet dënimit të parashikuar nga ligji.

29. Liria individuale është e garantuar. Asnjëri nuk mund të ndiqet, të burgoset ose të cenohet sadopak në lirinë e tij personale, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji dhe në format ligjore. Askush nuk mund të përjashtohet nga dalja përpara gjykatës së caktuar me ligj e as t'i nënshtrohet një dënimi të parashikuar nga ligji.

30. Banesa e çdo shtetasi shqiptar është e pacenueshme. Aty mund të hyhet me forcë vetëm në rastet dhe në format e parashikuara nga ligjet.

31. Çdo njeri është i lirë të zgjedhë vendbanimin e tij dhe të qarkullojë nëpër të gjithë vendin sipas kushteve që do të përcaktohen nga dispozitat e sigurimit publik.

32. Shqipëria nuk ka fe shtetërore. Liria dhe ushtrimi publik i të gjitha kulteve janë të siguruara. Në asnjë pjesë të principatës shqiptare, ndryshimi në fe nuk mund t'i vihet asnjëri si shkak për të përjashtuar ose për ta cilësuar si të paaftë përse i përket gëzimit të të drejtave civile e politike, pranimit në punë shtetërore, në funksione ose ndere ose përse i përket ushtrimit të profesioneve dhe aktiviteteve të ndryshme.

33. Të gjitha pasuritë e fituara ligjërisht janë të pacenueshme. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, veçse për shkak të dobisë publike në rastet e në format e përcaktuara nga ligjet dhe kundrejt një shpërblimi paraprak të drejtë.

34. Konfiskimi i pasurisë është i ndaluar.

35. Arsimi është i lirë. Nën mbikëqyrjen e qeverisë ai ushtrohet nga persona që kanë cilësitë e kërkuara nga ligji. Arsimi bëhet falas në shkollat fillore të shtetit. Arsimi fillor është i detyrueshëm për fëmijët shqiptarë kudo që ekzistojnë shkolla të shtetit. Mësimi i gjuhës shqipe është i detyrueshëm në të gjitha shkollat.

36. Secili është i lirë të shfaqë mendimet e tij gojarisht, me shkrim dhe nëpërmjet shtypit në përputhje me ligjet. Një ligj i posaçëm do të përcaktojë modalitetet e ushtrimit të kësaj lirie.

37. E drejta për t'u mbledhur, pa pasur me vete armë, u njihet të gjithë shtetasve shqiptarë, me kusht që këta t'u përshtaten ligjeve, që do të rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte. Kjo liri nuk zbatohet për mbledhjet në shesh të hapët, që u nënshtrohen ligjeve të mbikëqyrjes policore.

38. Shtetasit shqiptarë kanë të drejtën të krijojnë shoqata, po me kusht që në qëllimet dhe në mjetet e tyre të mos ketë asgjë të paligjshme dhe të rrezikshme për shtetin. Një ligj i posaçëm do të rregullojë ushtrimin e kësaj të drejte, me qëllim që të garantohet siguria publike.

39. Me përjashtim të rasteve të caktuara me ligj, fshehtësia e letrave dhe e telegrameve është e paprekshme. Një ligj i posaçëm do të përcaktojë përgjegjësinë e nëpunësve qeveritarë për cenimin e fshehtësisë së letrave dhe të telegrameve, që u bëhen personave të postës dhe të telegrafit.

Kapitulli IV

Legjislacioni

40. Asambleja Kombëtare është organi legjislativ i principatës së Shqipërisë.

41. Asambleja Kombëtare përbëhet nga:

- 1) anëtarë në bazë ligji;
- 2) anëtarë të zgjedhur nga popullsia;
- 3) anëtarë të caktuar nga princi.

42. Janë vetvetiu anëtarë (në bazë ligji) të Asamblesë: përfaqësuesit fetarë të myslimanëve, të katolikëve, të ortodoksëve, kryetari i bektashinjve, komisari i lartë shqiptar pranë Bankës Kombëtare Shqiptare.

43. Që një njeri të zgjidhet ose të caktohet si anëtar i Asamblesë Kombëtare, ai duhet të ketë nënshtetësinë shqiptare dhe vendbanim brenda kufijve të principatës.

44. Anëtarët e zgjedhur të Asamblesë Kombëtare zgjidhen me votim indirekt nga tre për çdo sanxhak. Princi cakton datën e zgjedhjeve.

45. Kur mbeten vende vakante, për shkak dorëheqjeje apo vdekjeje, anëtarët e zgjedhur ose të caktuar për të zënë këto vende, mund t'i mbajnë ato vetëm për atë kohë sa do të zgjasë mandati i paraardhësve të tyre.

46. Të gjithë anëtarët e Asamblesë Kombëtare marrin gjatë kohës që vazhdon sesioni për udhëtimin, vajtje e ardhje, një shpërblim prej 15 frangash në ditë. Ky shpërblim nuk jepet në raste mungese në seancat.

47. Anëtarët e Asamblesë Kombëtare që emërohen nga princi janë dhjetë.

48. Në nahijet këshilli komunal, i mbledhur nën kryesinë e mudirit, do të zgjedhë një delegat. Ky do të shkojë në kryeqendrën e kazasë dhe do të bashkohet me anëtarët e këshillit bashkiak dhe të këshillit të kazasë. Në kryesinë e kajmekamit ky trup elektoral do të zgjedhë dy delegatë, të cilët do të shkojnë në qendrën e sanxhakut dhe në kryesinë e mytesarifit, do të zgjedhin me shumicë absolute përfaqësuesit për në Asamblenë Kombëtare.

Kajmekami, mytesarifi dhe të gjithë funksionarët e emëruar nga qeveria nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në votim. Detyra e mytesarifit dhe e kajmekamit është vetëm të kryesojnë mbledhjen elektorale dhe të mbikëqyrin respektimin e rregullave përkatëse.

Në qoftë se dy kandidatë marrin një numër të barabartë votash atëherë zgjedhja bëhet me short.

49. Mund të zgjidhen si anëtarë të Asamblesë Kombëtare shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 30 vjeç dhe që dinë të lexojnë e të shkruajnë.

50. Nëpunësit e emëruar nga princi dhe nga qeveria nuk mund të zgjidhen si anëtarë të Asamblesë Kombëtare gjatë gjithë kohës që zgjatin funksionet e tyre.

51. Çdo zgjedhje për të qenë e vlefshme duhet të marrë vërtetimin e Asamblesë Kombëtare.

52. Asambleja Kombëtare mbledhet rregullisht në sesion të zakonshëm çdo vit. Ajo thirret, shtyhet (ndërpritet), mbyllet nga princi.

53. Kohëzgjatja e legjislaturës është katër vjet.

54. Asambleja Kombëtare mund të thirret në sesion të jashtëzakonshëm nga princi.

Fillimi dhe mbarimi i sesionit të jashtëzakonshëm, si dhe arsyet (e thirrjes së saj), fiksohen në vendimin e thirrjes.

55. Princi ka të drejtë të shpërndajë Asamblenë Kombëtare.

Akti i shpërndarjes parashikon edhe thirrjen e zgjedhësve brenda dyzet ditëve.

56. Në fillim të çdo legjislature dhe gjatë gjithë kohës që ajo zgjat, princi zgjedh një kryetar midis anëtarëve të Asamblesë Kombëtare.

Kryetari do të marrë një shpërblim vjetor të përgjithshëm prej 10.000 frangash. Asambleja Kombëtare ka dy nënkryetarë, që zgjidhen prej saj për gjithë kohën që zgjat legjislatura, menjëherë pasi fillon nga detyra Kryetari.

57. Me propozimin e Kryetarit të Asamblesë Kombëtare, princi do emërojë dy sekretarë që do të merren jashtë radhëve të Asamblesë. Ata do të kenë një rrogë vjetore prej 6.000 frangash.

58. Që Asambleja të mund të marrë vendime të vlefshme është e domosdoshme që të jenë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të saj. Vendimet merren me shumicën absolute të votave të anëtarëve të pranishëm.

Në rast se votat ndahen në dysh, propozimi i shqyrtuar quhet i hedhur poshtë.

Një shumicë prej pesë të tetash është e domosdoshme kur është fjala për të votuar një ligj, i cili sjell ndryshime një ligji themelor të principatës.

Për zgjedhjet që bëhen brenda për brenda Asamblesë, shumica absolute është e domosdoshme në votimi e parë; në votimin e dytë mjafton shumica relative.

59. Çdo anëtar i Asamblesë voton vetë personalisht. Votimi bëhet ose duke u ngritur në këmbë e duke u ulur, ose me thirrje nominale.

60. Një projektligj mund të adoptohet vetëm pasi të vihen në votë të gjithë nenet që e përbëjnë.

61. Rendi i brendshëm i Asamblesë sigurohet nga Kryetari i saj, sipas rregullores së brendshme.

Asnjëri, me përjashtim të agjentëve të forcës publike që janë ngarkuar të ruajnë Asamblenë, nuk mund të hyjë me armë brenda godinës që është rezervuar për mbledhje.

62. Seancat e Asamblesë Kombëtare janë publike. Peticionet duhet t'i paraqiten kryetarit ose drejtpërsëdrejti, ose nëpërmjet njërit prej anëtarëve të Asamblesë Kombëtare.

63. Asambleja mund të bëjë mbledhje të fshehta kurdoherë që këtë e kërkojnë të paktën një e treta e anëtarëve të pranishëm.

64. Anëtarët e Asamblesë, të çfarëdo kategorie qofshin, kanë të njëjtat të drejta, të njëjtat prerogativa dhe të njëjtat detyra. Ata janë të lirë të japin votat e tyre ose të abstenojnë, si dhe të shfaqin mendimet e tyre. Ato nuk mund të ndiqen për shkak të fjalimeve të tyre, të propozimeve që mund të bëjnë me shkrim ose të raporteve që mund të adaptojnë, veçse në ato raste kur këtë e kërkojnë gjashtë anëtarë, të cilët janë të detyruar të provojnë se fjalimi i mbajtur apo propozimi apo raporti i shkruar përmban një krim të parashikuar nga ligji. Ndjekja duhet të autorizohet nga Asambleja.

Asnjë ndjekje penale për faktet që s'kanë të bëjnë me funksionet e tyre, nuk mund të bëhet kundrejt anëtarëve gjatë kohës së sesionit, veçse në rast se ajo autorizohet nga Asambleja me kërkesën e prokurorit pranë gjykatës kompetente.

65. Asambleja përgatit dhe voton rregulloren e saj të brendshme.

66. Për fjalimet, për vërejtjet, për mocionet e tyre dhe për çdo shkrim që ka të bëjë me ushtrimin e funksioneve të tyre, anëtarët e Asamblesë Kombëtare duhet të përdorin gjuhën shqipe.

67. Në kuadrin e pushtetit legjislativ të Asamblesë hyjnë:

- 1) çdo ndryshim i ligjeve themelore të principatës;
- 2) ligjet që ndryshojnë ose shndërrojnë taksat ekzistuese;
- 3) ligjet që vendosin taksa të reja;
- 4) ligjet e buxhetit dhe ato që miratojnë llogaritë e një viti buxhetor të mbyllur, duke marrë parasysh marrëveshjet ndërkombëtare që mund të lidhen;
- 5) ligjet mbi kontribucionet indirekte;
- 6) traktatet e tregtisë dhe marrëveshjet me karakter ekonomik;
- 7) koncesionet që angazhojnë burimet e shtetit;
- 8) ndarjen administrative.

Të gjitha vendimet që merr Asambleja Kombëtare në fushën legjislative duhet t'i nënshtrohen princit për sanksionim.

68. Për të gjitha fushat e tjera princi, me propozimin e qeverisë, nxjerr dekrete që kanë forcën e ligjit. Ai mund të konsultojë asamblenë Kombëtare kurdoherë që e quan të nevojshme.

69. Në fillim të çdo sesioni të zakonshëm vjetor projekti i buxhetit për vitin vijues i paraqitet Asamblesë Kombëtare nga ministri i Financave.

Së bashku me këtë projekt, ministri i Financave i paraqet Asamblesë Kombëtare buxhetin rektifikativ të vitit buxhetor të mbyllur. Në qoftë se buxheti rektifikativ nuk hartohet në kohë, ai duhet të paraqitet, jo më vonë se në sesionin vijues.

70. Në qoftë se Asambleja pakëson ndonjë kredi të propozuar ose e suprimon fare, ajo duhet të japë shpjegime për votën e saj dhe të tregojë ku dhe si mund të realizohet kursimi.

71. Në qoftë se Asambleja, pasi ka dëgjuar shpjegimet, ose në qoftë se ajo arrin në fund të sesionit pa votuar buxhetin, princi me një urdhëresë që nxjerr pasi ka marrë një mundim të njëllojtë edhe nga Këshilli i Ministrave, mund ta bëjë buxhetin në vazhdim të zbatueshëm edhe për vitin buxhetor vijues, por duke zbritur shumat e parashikuara për një nevojë të caktuar, kur kjo është plotësuar.

Kapitulli V

Organet e qeverisë

A) Ministrinë dhe ministrat

72. Qeveria shqiptare përbëhet nga një Këshill Ministrash në krye të të cilit është një kryeministër.

Në rast mungese dhe paaftësie të kryeministrit, Këshilli thirret dhe kryesohet prej ministrit më të vjetër në moshë.

73. Ministrinë janë këto:

Ministria e Punëve të Jashtme,

Ministria e Punëve të Brendshme,

Ministria e Financave,

Ministria e Drejtësisë.

74. Kryetari i Këshillit është në të njëjtën kohë ministër i punëve të Jashtme.

75. Çdo ministri i caktohet si ndihmës një sekretar i përgjithshëm.

76. Të gjithë ministrat emërohen nga princi, atij i bëhet betimi dhe në çdo rast dorëheqjeje, atij i dorëzohet pushteti.

77. Çdo ministri ndahet në departamente të kryesuara nga drejtorë të përgjithshëm. Çdo departament është i ndarë në seksione.

78. Ministria e Punëve të Brendshme ka pesë departamente: 1) administrata; 2) xhandarmëria dhe milicia; 3) bujqësia, tregtia, lundrimi dhe industria; 4) posta dhe telegrafi; 5) shëndetësia.

79. Ministria e Financave ndahet në pesë departamente: 1) thesari dhe huaja publike; 2) doganat; 3) taksat, kontributet dhe monopolet; 4) llogaria e përgjithshme e shtetit; 5) punët botërore.

80. Ministria e Drejtësisë ndahet në tri departamente: 1) drejtësia; 2) kultet (fetare); arsimi.

81. Çdo ligj që krijon një shërbim (publik) të ri duhet të përcaktojë edhe ministrinë si dhe departamentin ku do të hyjë ky shërbim.

82. Këshilli i Ministrave harton projektligjet, dekretet princore, si dhe urdhëresat administrative të interesit të përgjithshëm; ai shfaq mendimin e vet mbi çështjet që i shtrohen nga princi dhe nga ministrat e ndryshëm.

83. Shkarkimi i sekretarëve dhe i drejtorëve të përgjithshëm, si dhe i shefave të seksioneve mund të bëhet vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave sipas propozimit të ministrin kompetent.

84. Ministrat përgjigjen përpara princin.

Një ligj i posaçëm do të përcaktojë procedurën që do të ndiqet në rast shpërdorimi të pushtetit.

85. Anëtarët e familjes princore nuk mund të emërohen ministra.

B. Organizimi i shërbimit të shtetit.

86. Çdo person i ngarkuar me një shërbim që i përket shtetit konsiderohet si nëpunës i shtetit.

87. Të gjitha emërimet e nëpunësve bëhen në përputhje me rregullat që përcaktojnë edhe kushtet përkatëse.

88. Çdo nëpunës, para se të fillojë nga kryerja e detyrave të tij, duhet të bëjë betimin e besnikërisë dhe të respektit ndaj princin dhe ligjeve të vendit.

89. Çdo nëpunës që jep prova sjelljeje të mirë, ndershmërie dhe aftësie në kryerjen e

detyrave të tij, ka të drejtën e gradimit dhe të shpërblimeve të tjera sipas dispozitave që do të përcaktohen me rregullore të posaçme.

90. Çdo nëpunës duhet të përmbushë me ndërgjegje detyrat që i janë besuar; ai duhet të ruajë fshehtësinë profesionale dhe t'u bindet urdhërave të eprorëve të tij, me kusht që këto urdhëra të jenë brenda caqeve të vendosura nga ligji.

91. Çdo nëpunës që shkel betimin dhe nuk i kryen detyrat, mund të shkarkohet dhe të ndëshkohet sipas dispozitave dhe me garancitë që caktohen nga ligjet.

92. Ndëshkimet disiplinore, përveç rasteve që hyjnë në kompetencën e gjykatave të zakonshme, duhet të zbatohen sipas rregulloreve të brendshme të çdo ministrie. Ato janë: qortimi, pezullimi i funksioneve dhe i rrogës, shkarkimi.

93. Në rast grumbullimi të detyrave shtetërore nëpunësi do të marrë vetëm shpërblimin më të lartë që parashikohet për këto detyra.

94. Nëpunësit që merren në punë me kontratë nuk kanë të drejta të tjera kundrejt shtetit veç atyre që rrjedhin nga kontrata.

Kapitulli VI

Administrata lokale

95. Shqipëria ndahet në shtatë sanxhaqe, që janë: Shkodra, Elbasani, Dibra, Durrësi, Berati, Korça dhe Gjirokastra.

96. Kryeqendrat e këtyre sanxhaqeve janë qytetet, emrat e të cilave mbajnë sanxhaqet vetë, me përjashtim të sanxhakut të Dibrës, kryeqendra e të cilit do të caktohet nga qeveria.

97. Sanxhaqet ndahen në kaza dhe kazatë në nahije.

98. Kufijtë e sanxhaqeve caktohen me ligj. Në caktimin e këtyre kufijve ligji merr parasysh nevojat administrative, interesat lokale dhe lehtësitë e komunikacionit. Projektligji i lidhur me caktimin e kufijve administrativë duhet të paraqitet nga Ministria e Brendshme në sesionin e parë të Asamblesë Kombëtare. Deri atëherë, kufijtë mbeten përkohësisht ato që kanë qenë nën administratën otomane, veç kur një dekret i princit vendos ndryshe. Ndërkaq sanxhaku i Dibrës do të përbëhet nga pjesa që mbetet prej sanxhakut të vjetër të Dibrës dhe nga tokat e vilajetit të Kosovës që iu caktuan Shqipërisë.

Për sa u përket krahinave të Jugut, kazaja e Leskovikut, që varej më parë nga sanxhaku i Janinës, do të futet në sanxhakun e Korçës, kurse fshatrat e Çamërisë, që i mbeten Shqipërisë, do të futen në sanxhakun e Gjirokastrës.

99. Kufijtë (e njësisve administrative) mund të ndryshohen vetëm me një ligj të ri.

Sanxhaqet

100. Sanxhaku administrohet nga një mytesarif, i cili për të gjitha çështjet administrative përgjigjet përpara ministrit të Brendshëm dhe përpara ministrave kompetentë për të gjitha çështjet e tjera.

101. Në rast mungese, ai ia lë drejtimin e punëve njerit prej anëtarëve të këshillit të tij, në radhë të parë më të vjetrit në moshë ndërmjet anëtarëve që janë caktuar me ligj. Në rast pushimi të zakonshëm, i takon Ministrisë së Brendshme të zgjedhë zëvendësin e mytesarifit.

102. Ai ka nën varësinë e tij të drejtpërdrejtë xhandarmërinë dhe policinë.

103. Në bashkëpunim me këshillin e tij, ai cakton buxhetin e sanxhakut të tij dhe ia parashtron qeverisë qendrore.

104. Ai duhet të inspektojë një herë në vit të gjitha kazatë që ndodhen nën administrimin e tij.

105. Ai është përgjegjës bashkë me kryellogaritarin për drejtimin e financave të sanxhakut të tij. Për këtë qëllim, ai mund të kontrollojë, kurdoherë që e gjykon të nevojshme, arkat e sanxhakut dhe të kazasë.

106. Duke qenë personalisht përgjegjës për qetësinë publike, ai mund të marrë, në rast ngutësie absolute, masa të jashtëzakonshme sigurimi, por me kusht që të vërë menjëherë në dijeni për këto qeverinë qendrore.

107. Meqenëse gjykatat janë të pavarura nga administrata civile, mytesarifi në asnjë mënyrë nuk mund të përzihet në çështjet gjyqësore. Por ai ka për detyrë të japë ndihmën dhe mbështetjen e duhur për ekzekutimin e vendimeve.

108. Zbatimi i ligjeve dhe i dekreteve që kanë të bëjnë me arsimin publik dhe me inspektimin e të gjitha institucioneve shkollore hyjnë në kompetencën e mytesarifit.

Këshilli i sanxhakut

109. Mytesarifi ndihmohet nga një këshill që quhet këshilli i sanxhakut dhe që është nën kryesinë e tij.

110. Ky këshilli përbëhet: 1) nga anëtarë të caktuar me ligj (sekretari i përgjithshëm, kryellogaritari, drejtori i arsimit publik, drejtori i punimeve botore, drejtori i bujqësisë dhe i tregtisë) dhe 2) nga anëtarë të zgjedhur (një për çdo kaza, duke përfshirë edhe kazanë qendrore).

111. Zgjedhjet janë indirekte dhe bëhen sipas shembullit të zgjedhjeve të anëtarëve të Asamblesë Kombëtare.

112. Funksionet e anëtarëve të zgjedhur zgjasin tre vjet. Këta mund të rizgjidhen.

113. Këshilli mblidhet tre muaj çdo vit, në kryeqendrën e sanxhakut. Në rast nevoje, mytesarifi mund të zgjasë sesionin edhe për një muaj tjetër.

114. Anëtarët e zgjedhur marrin një shpërblim prej dyqind frangash në muaj gjatë kohës së sesionit.

115. Vendimet merren me shumicë votash. Kur votat ndahen barabar, vendos vota e kryetarit.

116. Mytesarifi nuk mund të shtyjë zbatimin e një vendimi të marrë me shumicë votash, veçse nën përgjegjësinë e tij personale dhe me kusht që ai të vërë menjëherë në dijeni ministrinë kompetente.

117. Çështjet që i përkasin vetëm e vetëm këshillit të sanxhakut të mbledhur në sesionin plenar, janë:

- . hartimi i buxhetit të sanxhakut;
- . kontrolli i administrimit të financave;
- . rishikimi i caktimit dhe i vjeljes së taksave dhe të tatimeve;
- . hapja dhe funksionimi i institucioneve shkollore, përmirësimet që duhen bërë në to;
- . studimi i projekteve, i planeve dhe i preventivave të punëve botore që duhen zbatuar brënda kufijve të sanxhakut dhe që duhet t'i parashtrihen qeverisë qendrore për miratim;
- . shërbimet e qarkullimit e të transportit;

- . përmirësimi i bujqësisë dhe i blegtorisë;
 - . prerja e drurëve në pyjet që u përkasin komunave (baltaliqet e vjetra).
 - . ripyllëzimi i vendit.
 - . votimi për qindarkat që mund t'u shtohen taksave dhe tatimeve me kusht që të merret pëlqimi i qeverisë.
 - . ngritja dhe mirëmbajtja e spitaleve dhe e institucioneve bamirëse.
 - . vendosja e stabilimenteve industriale e të tjerë.
 - . shfrytëzimi i mademeve.
118. Të gjitha çështjet e tjera mund të trajtohen e të vendosen nga mytesarifi së bashku me anëtarë te përhershëm të këshillit.

Kazatë

119. Kazaja administrohet nga një kajmekam. Në rast mungese ai ia lë drejtimin e punëve njërit prej anëtarëve të këshillit të tij, në radhë të parë më të vjetrit në moshë ndërmjet anëtarëve të caktuar në bazë ligji. Në rast pushimi të zakonshëm i takon mytesarifit të zgjedhë zëvendësin e tij.

120. Kajmekami ngarkohet me ruajtjen e rendit publik e të qetësisë. Për këtë qëllim ai ka nën urdhrat e tij policinë dhe xhandarmërinë. Në qoftë se forcat që ndodhen në kaza janë të pamjaftueshme, ai mund t' i kërkojë, po qe nevoja, përforcime mytesarifit.

121. Financat e kazasë i besohen një llogaritari. Kajmekami është përgjegjës për financat e kazasë me të njejtat të drejta dhe me të njejtat kushte sikurse mytesarifi në sanxhak.

122. Njësoj si mytesarifi, kajmekami nuk ka të drejtë të përzihet në çështjet gjyqësore.

123. Kajmekami vendos për çështjet që vijojnë:

- lëshimi i pasaportave;
- lëshimi i lejeve për gjueti dhe për mbajtjen e armëve;
- legalizimi i nënshkrimeve të autoriteteve të kazasë;
- autorizimi i vënies në qarkullim i shërbimeve publike të transportit;
- autorizimi i vendshitjeve të pijeve pas mendimit të favorshëm të bashkisë;

Këshilli i kazasë

124. Kajmekami ndihmohet nga një këshilli që quhet këshilli i kazasë dhe që është nën kryesinë e tij.

125. Këshilli përbëhet: 1) nga anëtarë të caktuar në bazë ligji (sekretari, llogaritari, drejtori i tatimeve mbi tokat) dhe 2) nga katër anëtarë që zgjidhen, me shumicën absolute të votueve të pranishëm, prej këshillave komunale që mbliidhen në kryeqendrën e kazasë me thirrje të kajmekamit.

126. Funksionet e anëtarëve të zgjedhur zgjasin tre vjet. Këta mund të rizgjidhen.

127. Këshilli funksionon gjithë vitin. Ai mbliidhet të paktën një herë në javë.

128. Anëtarët e zgjedhur nuk marrin as rrogë, as shpërblim.

129. Vendimet merren me shumicën e votave. Kur votat ndahen barabar, vendos vota e kryetarit.

130. Kajmekami nuk mund të shtyjë zbatimin e një vendimi të marrë me shumicë votash, veçse nën përgjegjësinë e tij personale dhe me kusht që ai të vërë menjëherë në dijeni mytesarifin prej të cilit varet.

131. Çështjet që i përkasin vetëm e vetëm këshillit të kazasë janë homologimi (miratimi) i tarifave për të drejtën e vendit në pazaret, në panairt dhe në tregjet;

homologimi i tarifave të taksave të peshimit, të vëllimit dhe të matjes;

autorizimi i aksioneve për asgjësimin e kafshëve të dëmshme në pyjet e komunave;

kontrolli i buxhetit dhe i llogarive të institucioneve bamirëse dhe i administrimit të pasurive të tyre; autorizimi i pranimit të dhuratave dhe legeve për komunat dhe institucionet bamirëse;

Nahijet

132. Nahija përbëhet nga një grup fshatrash të lidhura gjeografikisht dhe ekonomikisht, me një popullsi globale prej 4000 - 7000 frymësh.

133. Çdo nahije administrohet nga një mudir, që ndihmohet prej një këshilli komunal.

134. Këshilli komunal përbëhet nga sekretari i nahijes dhe nga katër anëtarë të zgjedhur.

Zgjedhjet bëhen me shumicën e votave nga muhtarët e fshatrave që përbëjnë nahijen, të mbledhur në kryeqendrën e nahijes nën kryesinë e muhtarit të kryeqendrës.

135. Mudiri ka si detyra:

botimin dhe zbatimin e ligjeve, të dekreteve, të vendimeve dhe të urdhërësive të qeverisë; regjistrimin e popullsisë;

kontrollin e vjeljes së taksave dhe të tatimeve.

136. Këshilli vendos për çështjet që vijojnë:

çështje të higjienës publike;

rrugët e komunikacionit midis fshatrave;

mirëmbajtja e çezmave, e puseve, e cisternave, e ujësjellësve, përmirësimi i vijave të ujit;

ujitja e tokave të punuara, kanalet vaditëse, digat;

përmirësimi i bujqësisë dhe i blegtorisë;

kullotat komunale.

137. Hollësitë e kompetencave të mësipërme, si dhe të gjitha kompetencat e tjera të mytesarifëve, të kajmekamëve, të mudirëve dhe të këshillave pranë tyre; do të përcaktohen me rregullore të posaçme. Derisa të hartohen këto rregullore, administrata lokale do të vazhdojë të funksionojë si në të kaluarën.

138. Për sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtën për t'u zgjedhur, ligjet ekzistuese do të mbahen përkohësisht në fuqi, derisa të dalë një ligj i ri.

Bashkitë

139. Në kryeqendrat e sanxhaqeve e të kazave do të ketë një bashki, sikurse edhe në çdo qytet me një popullsi prej më tepër se 2500 frymësh.

140. Ligjet që rregullojnë funksionimin e bashkive do të mbeten në fuqi derisa të dalë një ligj i ri.

Kapitulli VII

Financat

141. Administrata e financave dhe degët që varen prej saj do të organizohen sipas rregulloreve të posaçme. Ndërkohë, organizimi i mëparshëm i financave do të vazhdojë të jetë në fuqi, me ndryshime të një rëndësie të dorës së dytë, që mund t'i bëhen me dekret princor.

142. Asnjë ngarkim fiskal, veç atyre që ekzistojnë; nuk mund të vihet pa ligj.

143. Asnjë shpenzim nuk mund të bëhet po qe se ai nuk është parashikuar nga buxheti. Në rast nevoje të ngutshme, princi pasi merr edhe mendimin e Këshillit të Ministrave, mund të nxjerrë një dekret shpenzimi të jashtëzakonshëm, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare që mund të lidhen eventualisht. Në sesionin e parë të Asamblesë Kombëtare ky shpenzim duhet t'i parashtrohet Asamblesë për konfirmim.

Kapitulli VIII

Punët botore

144. Departamenti i punëve botore do të ketë veç drejtorit të përgjithshëm, një arkitekt, një inxhinier urash e rrugësh dhe një ekspert për punimet e kanalizimit e të tharjes. Këta nëpunës, të cilëve ministria mund t'u shtojë çdo specialist tjetër që do ta gjykojë të nevojshëm, do të formojnë këshillin e përhershëm të seksionit.

145. Punimet me dobi publike mund të kryhen drejtpërdrejt nga qeveria ose mund t' u jepen koncesion sipërmarrjeve private.

146. Projektet e rrugëve, që duhet të ndërtohen nga qeveria, përpilohen nga departamenti i mësipërm; ato të rrugëve krahinore nga këshillat e sanxhaqeve dhe ato të udhëve që lidhin fshatrat nga këshillat e komunave. Në të dyja rastet e fundit projektet e përpiluara në këtë mënyrë duhet t'i dërgohen për miratim departamentit të punëve botore, i cili do të mbikëqyrë zbatimin.

147. Shpenzimet e ndërtimit dhe të mirëmbajtjes së rrugëve kombëtare dhe krahinore hyjnë në buxhetin e shtetit. Ato të udhëve të fshatrave janë në ngarkim të komunave, të cilat mund të autorizohen nga këshillat e sanxhaqeve që të vendosin taksa kalimi në rastet kur burimet e tyre janë të pamjaftueshme. Këto taksa kalimi mund të mbahen vetëm për aq kohë sa do ta gjykojë të nevojshme këshilli.

148. Mbikëqyrja e ndërtimit, si dhe e shërbimit të hekurudhave, që do të ndërtohen në Shqipëri, qoftë nga shteti vetë apo nga shoqëri koncesionare, janë në kompetencën e departamentit të punëve botore, i cili, në rast nevoje mund të marrë si bashkëpunëtorë inxhinierë specialistë.

Kapitulli IX

Forcat e Armatosura

149. Forca e armatosur përbëhet prej xhandarmërisë dhe prej milicisë.

A) Xhandarmëria

150. Meqenëse organizimin e xhandarmërisë Fuqitë e Mëdha ia kanë besuar Misionit Holandez, ky i fundit do të hartojë rregulloren përkatëse. Kjo rregullore do të hyjë në fuqi vetëm pasi të miratohet nga princi.

B. Milicia

151. Milicia është një forcë ushtarake vendase territoriale dhe sedentare. Ajo zë vend zakonisht në qendrat e saj dhe nuk mund të mobilizohet tërësisht ose pjesërisht veçse me dekret të princit.

152. Milicia ka për detyrë në kohë paqeje të mbështetë eventualisht veprimet e xhandarmërisë për ruajtjen e rendit publik brënda vendit.

153. Çdo banor vendas i principatës është i detyruar të kryejë personalisht shërbimin ushtarak në radhët e milicisë dhe të rezervës së saj.

154. Zëvendësimet nuk lejohen.

155. Përfshihen përgjithnjë nga shërbimi vetëm ata që janë fizikisht të paaftë.

156. Formimi dhe organizimi i milicisë do të jetë objekt i një ligji të veçantë.

157. Në rast se organizimi i milicisë shtron nevojën e përdorimit të oficerëve të huaj, kufizimi i parashikuar nga Konferenca e Londrës përse i përket përdorimit të oficerëve për organizimin e xhandarmërisë, vlen edhe për milicinë; përjashtim mund të bëhet vetëm në marrëveshje midis qeverisë princore dhe Fuqive të Mëdha.

158. Në rast nevoje, princi, me dekret të posaçëm, mund të rekuizojë kafshët e barrës dhe mjetet e transportit, si dhe ushqimet, brënda kufijve dhe me kushtet e përcaktuara në të njëjtin dekret.

Kapitulli X

Drejtësia

159. Autoritetet gjyqësore janë: 1) këshilli i pleqve; 2) gjykatësit paqtues; 3) gjykatat e shkallës së parë; 4) gjykatat e apelit.

160. Këshilli i pleqve ndodhet në çdo fshat, formohet sipas ligjit. Ai është kompetent për rastet që rrjedhin nga dëmet që bëhen në fshat të cilat shkaktojnë një gjobitje prej dhjetë deri në njëqind franga.

161. Gjykatësit e paqit do të emërohen me dekret princor. Ata do të vendosen në vendet që do të caktohen me dekret ministror; ata janë kompetentë të gjykojnë në fushën civile, pa apel, grindjet për shuma prej 100 deri 500 franga; në fushën penale, ata shqyrtojnë shkeljet e dënueshme me burgim njëzet e katër orësh deri në një javë, pa apel dhe prej një jave deri në tre muaj, me apel.

162. Gjykatat e shkallës së parë do të ngrihen në çdo sanxhak, si dhe ato kaza ku do të shihet nevoja. Ato do të përbëhen nga një kryetar, dy ndihmësgjyqtarë, një prokuror, një gjyqtar hetues, dy sekretarë dhe dy ftues.

163. Në fushën civile këto gjykata do të kenë kompetencë të gjykojnë, pa apel, të gjitha çështjet që kapin vlerën prej më se 500 frangash deri në 1000 frangash dhe me apel të gjitha çështjet e tjera. Për çështjet tregtare, këto gjykata do të shndërrohen, sikur se nën regjimin otoman, në gjykata tregtie. Në fushën penale, ato do të gjykojnë të gjitha krimet dhe kundërvajtjet. Veç asaj, ato do të gjykojnë në shkallë të dytë çështjet që vijnë nga gjykatësit e paqit.

164. Do të ketë tri gjykata apeli, selitë e të cilave do të caktohen nga qeveria. Ato do të përbëhen nga një kryetar, katër këshilltarë, një prokuror, një zëvendësprokuror, dy kancelarë, një sekretar dhe dy ftues.

Ato janë kompetente të gjykojnë në shkallë të dytë të gjitha çështjet civile e penale të gjykuara nga gjykatat e instancës së parë.

165. Gjyqtarët janë të palëvizshëm. Kushtet që duhet të plotësojnë gjyqtarët e të gjitha kategorive lidhur me emërimin, me gradimin e tyre do të trajtohen në një ligj të posaçëm.

166. Veç kompetencave që parashikohen nga ky statut, gjykatësit e paqit, gjykatat e instancës së parë dhe gjykatat e apelit mund të kenë edhe detyra të tjera që mund t'u ngarkohen nga ligje të ndryshme.

167. Një ligj i veçantë do të përcaktojë krijimin dhe detyrat e noterisë.

168. Ngritja e një gjykate më të lartë se gjykata e apelit, si dhe e çdo gjykate tjetër të posaçme lihet në gjykimin e princit dhe të qeverisë së tij.

169. Prokurori dhe zëvendësi i tij e zhvillojnë veprimtarinë publike në të gjithë sferën e juridiksionit të gjykatës. Ata kujdesen për ruajtjen e rendit në gjykatat dhe për zbatimin e vendimeve që janë dhënë. Mbikëqyrja e policisë gjyqësore u takon atyre.

Në fushën civile prokurori vepron sa herë që këtë e kërkojnë interesat e ligjit. Ai merr pjesë në seancat dhe jep konkluzionet e tij.

Prerogativat e konsullatave në fushën gjyqësore ruhen ashtu siç rrjedhin nga kapitulacionet.

Kapitulli XI

Kultet

170. Të gjitha komunitetet fetare shqiptare ekzistuese njihen (nga shteti). Ky parim zbatohet edhe për sektet e ndryshme myslimane. Asnjë pengesë nuk duhet të nxirret për organizimin hierarkik të komuniteteve të ndryshme e as për marrëdhëniet që këto mund të kenë në çështje të dogmës fetare, me kryetarët e tyre shpirtërorë më të lartë.

171. Komunitetet fetare në Shqipëri do të ruajnë pasuritë e tyre.

172. Komunitetet do të vazhdojnë të marrin, nën mbrojtjen e autoriteteve, të ardhurat e konsakruara nga zakoni.

173. Përjashtohen nga taksat godinat që shërbejnë për kultet, për arsimin publik dhe për veprat bamirëse.

174. Në rast se formohen komunitete fetare të reja të kulteve të ndryshme, shteti rezervon të drejtën t'i njohë dhe të përcaktojë të drejtat e tyre.

175. Klerikët dhe paria e të gjitha komuniteteve fetare të njohura prej shtetit do të marrin investiturën nga lartësia e tij princi.

176. Rregullimi i marrëdhënieve midis kishave ekzistuese në Shqipëri dhe kryetarëve të tyre shpirtërorë më të lartë do të jetë objekt i marrëveshjeve të posaçme që do të lidhen midis qeverisë shqiptare dhe këtyre krerëve.

177. Shteti duhet të marrë masa për mbajtjen e të gjitha kulteve të njohura, si dhe të klerit duke caktuar për këtë qëllim shumën që do të gjykojë të nevojshme në buxhetin e përgjithshëm shtetëror; do të ketë parasysh edhe pasuritë e patundshme që kanë aktualisht këto kulte.

Kapitulli XII

Arsimi publik

178. Mbajtja e shkollave të shtetit dhe e shkollave të komuniteteve shqiptare është në ngarkim të shtetit. Një ligj i posaçëm do të rregullojë funksionimin e këtyre shkollave.

179. Në shkollat vendase mësimi në gjuhën shqipe është i detyrueshëm. Por mësimi fetar mund të bëhet vetëm në gjuhën e kultit.

180. Mësuesit e gjuhëve të huaja mund të jenë shtetas të huaj. Të gjithë të tjerët duhet të jenë shtetas shqiptarë, me përjashtim të rasteve, kur ka një autorizim të posaçëm të qeverisë.

181. Ngritja dhe funksionimi i shkollave teologjike, të mjeshtërive dhe të zanateve të arteve të bukura, si dhe i çdo arsimit teknik do të rregullohen me ligje të posaçme.

182. Qeveria mbikëqyr funksionimin e të gjitha institucioneve shkollore dhe respektimin e ligjeve përkatëse.

Kapitulli XIII

Prona tokësore

183. Në Shqipëri pronat e patundshme ndahen në pronat private, në pronat publike dhe në pasuri të dhuruara.

184. Pronat private janë ato që u përkasin një ose më shumë personave si dhe personave juridikë. Çdo zotërim duhet të provohet me dokumente zyrtare ose me çdo mjet tjetër të parashikuar nga ligji otoman mbi tokat.

185. Pronat publike ose shtetërore janë dy llojesh; ato për të cilat shteti e ka mbajtur vetë të drejtën e shfrytëzimit dhe ato për të cilat shteti u ka dhënë të drejtën mbi të ardhurat e komunave të ndryshme (si p.sh. baltatik ose e drejta e prerjes së drurëve, merá ose e drejta e kullotjes).

186. Pasuritë “e dhuruara” ose vakëfet janë ato që u janë lënë trashëgim institucioneve fetare ose shkollore, fondacioneve bamirëse.

187. Me daljen e Shqipërisë si një shtet i pavarur e sovran, të gjitha tokat mirie kthehen në toka mulk, d.m.th. në pronë private të plotë e të lirë.

188. Trashëgimi i të gjitha pronave të patundshme do të bëhet sipas dispozitave të ligjit lidhur me (tokat) mirie.

189. Leget e tokave të punueshme, të pyjeve, të kullotave, të livadheve, të vreshtave, të perimoreve në favor të institucioneve fetare ose shkollore, të organizatave mëshiruese dhe bamirëse myslimane (vakëfeve) janë të ndaluara. Leget në favor të personave juridikë, që u nënshtrohen ligjeve civile të vendit, janë të lira.

190. Të ardhurat e pasurive të kushtuara (vakëfeve) mund të sekuestrohen për borxhe, juridikisht të konstatuara, të institucioneve ose të komuniteteve, të cilave këto pasuri u përkasin. Për të siguruar të drejtat e tyre, kreditorët e këtyre komuniteteve ose institucioneve mund të kërkojnë nga gjykata civile vënien nën sekuestër të këtyre pasurive.

191. Çdo pronar, toka e të cilit është e ngarkuar me servitute të vendosura ligjërisht, për t'u liruar duhet t'i drejtohet gjykatës kompetente, e cila vendos për lirimin dhe, po qe rasti, cakton edhe shumën, si dhe mënyrën e pagimit. Në qoftë se nga ky servitut përfiton një komunë që nuk ka arkë komunale të organizuar, shpërblimi i caktuar derdhet në Bankën Kombëtare, e cila u paguan kamatat vjetore personave që kanë të drejtë. Kapitali nuk mund të preket e të përdoret veçse me autorizim të posaçëm të qeverisë.

192. Hipotekimi i pronave tokësore është i lejuar. Një ligj i veçantë do të rregullojë hollësisht dhe kushtet.

193. Neni 33 parashikon dhe rregullon kushtet dhe rastet e shpronësimit.

194. Qeveria duhet të hartojë sa më shpejt dy projektligje, njërin për krijimin e një kadastre të pronave tokësore, që ndodhen brënda kufijve të principatës, tjetrin për ndryshimin e organizimit të vakëfeve.

Kapitulli XIV

Bujqësia, tregtia, industria

195. Departamenti i bujqësisë, i tregtisë dhe i industrisë ndahet në dy seksione: a) bujqësia, b) tregtia, industria, lundrimi; që do të kenë secili nga një shef seksioni në krye.

a) Bujqësia

196. Seksioni i bujqësisë do të përfshijë, veç shefit të tij, një inxhinier agronom, një inspektor të përgjithshëm të pyjeve dhe një drejtor të kadastrës. Këta nëpunës përbëjnë bashkërisht këshillin e përhershëm të seksionit.

197. Seksioni i bujqësisë ka për detyrë të studiojë masat që mund të mbrojnë, të nxisin dhe të zhvillojnë bujqësinë në të gjitha degët e saj, pyllëzimin e vendit dhe përmirësimin e racës së kafshëve shtëpiake. Ai duhet të kujdeset për krijimin e fermave model dhe të qëndrave të ndërzimit.

198. Derisa departamenti i bujqësisë të ketë përpunuar dispozitat përkatëse, ligjet dhe rregulloret që janë tani në fuqi në Perandorinë Osmane lidhur me zbulimin, dhënien në koncesion dhe shfrytëzimin e minierave, do të vazhdojnë të mbahen në fuqi në Shqipëri. Të drejtat e koncesioneve dhe lejet e kërkimeve që janë dhënë në përputhje me ligjet ekzistuese, gjatë regjimit të mëparshëm, duhet të respektohen e të mbahen nga shteti i ri.

199. Edhe ligjet e urdhëresat osmane që kanë të bëjnë me pyjet do të qëndrojnë gjithashtu në fuqi deri në një urdhër të dytë. Inspektori i përgjithshëm i pyjeve ngarkohet me zbatimin e tyre.

b) Tregtia, industria, lundrimi

200. Ushtrimi i veprimtarive në fushën e tregtisë, të industrisë, si dhe ushtrimi i zejeve është i lirë.

201. Për hapjen e fabrikave dhe të uzinave duhet marrë më parë leja e autoriteteve kompetente, sipas rregulloreve që do të nxjerrë për këtë qëllim seksioni i tregtisë.

202. Shteti nuk mund të vendosë monopole, të cilat mund të cënonin detyrimet ekzistuese.

203. Me autorizimin e ministrit kompetent do të krijohen dhoma tregtie e industrie. Çdo tregtar që paguan taksën e fitimit mund të regjistrohet si anëtar i dhomës së tregtisë. Kjo e fundit do të zgjedhë një komitet administrues, i cili nga ana e tij, do të zgjedhë një kryetar.

204. Dhomat e tregtisë të krijuara në këtë mënyrë, do të përfaqësojnë interesat e tregtarëve dhe do të shtrohet çështja e hartimit të projektligjeve lidhur me tregtinë dhe me industrinë, si dhe në çdo rast tjetër që mund të prekë interesat e tregtisë.

205. Lundrimi në portet dhe në ujrat territoriale shqiptare është i lirë për anijet e të gjitha shtetësive në përputhje me traktatet dhe marrëveshjet ekzistuese.

206. Çdo anije e flotës tregtare shqiptare duhet të shënohet në regjistrat që duhet të mbahen në portet e caktuara nga qeveria shqiptare.

207. Dispozita të posaçme që duhet të nxirren nga ministria, do të rregullojnë çështjet e matjes së kapacitetit të anijeve, të kualifikimit të kapitenëve, timonierëve dhe të makinistëve, si dhe të shërbimit të porteve.

208. Qeveria shqiptare do të caktojë, po ta gjykojë të udhës, një flamur të veçantë për flotën tregtare.

Kapitulli XV

Posta, telegrafi, telefoni

209. Departamenti i postës dhe i telegrafit ndahet në dy seksione: a) posta, b) telegrafi dhe telefoni, që do të kenë secili një shef seksioni në krye.

210. Për sa i përket administrimit të postës dhe të telegrafit në të gjitha pjesët e principatës, ai do të jetë në duart e qeverisë shqiptare, por se kjo do të respektojë të drejtat e fituara qysh më parë. Për sa i përket shërbimit telefonik, qeveria, po ta shohë të volitshme, mund t'ia japë si koncesion industrisë private.

Kapitulli XVI

Marrëdhëniet e jashtme

211. Kryetari i Këshillit të Ministrave, në cilësinë e tij si Ministër i Punëve të Jashtme, shërben si ndërmjetës midis sovranit dhe përfaqësuesve të huaj të akredituar pranë tij; ai merr masat e nevojshme për të siguruar agremanin për ministrat (fuqiplotë) si dhe për t'u lëshuar ekzekuaturat konsujve të vendeve të huaja.

Ai i paraqet sovranit për miratim emrat e përfaqësuesve diplomatikë e konsullorë që janë për t'u emëruar për jashtë shtetit.

212. Nëpunësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme mund të vihen në dispozicion pa gjykim dhe pa dhënë arësyet e një mase të tillë.

Kapitulli XVII

Konfliktet administrative

213. Për konfliktet administrative do të krijohen gjykata të posaçme. Ata do të shqyrtojnë ankesat e personave qoftë fizikë apo juridikë kundër veprimeve dhe mosveprimeve të organeve administrative për të vënë në vend një të drejtë të fituar.

Veç asaj, një ligj i veçantë do të përmbajë çështjet që do t'u jepen për shqyrtim këtyre gjykatave. Po ky ligj do të rregullojë procedurën dhe do të caktojë afatet e apelit.

214. Një gjykatë e instancës së parë do të ngrihet në kryeqendrën e çdo sanxhaku. Kryetari i saj do të zgjidhet nga princi midis gjyqtarëve të gjykatave të zakonshme të instancës...

STATUTI ORGANIK I SHQIPËRISË

/Vlorë, 10 prill 1914/

Kapitulli I

Shqipëria dhe territori i saj

1. Shqipëria formohet si një principatë kushtetuese, sovrane dhe e trashëgueshme nën garancinë e të gjashtë Fuqive të Mëdha.

2. Shqipëria është e pandashme, territori i saj është i patjetërsueshëm. Kufijtë e principatës janë ata që janë përcaktuar nga të gjashtë Fuqitë e Mëdha. Këta kufij nuk mund të ndryshohen apo të rektifikohen, veçse me anë të një ligji dhe me miratimin paraprak të gjashtë Fuqive të Mëdha.

3. Shqipëria është neutrale; neutraliteti i saj është i garantuar nga të gjashtë Fuqitë e Mëdha. Ky neutralitet nuk përjashton të drejtën e Shqipërisë për të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e territorit të saj. Megjithatë, porti tregtar ku do të dalë hekurudha ndërkombëtare që do të lidhë Serbinë me Adriatikut, do t'i nënshtrohet një regjimi të posaçëm, i cili do të përmbajë detyrimin që ky vend të mos fortifikohet.

4. Traktatet dhe konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të çfarëdo natyre qofshin, të lidhura midis Portës dhe fuqive të huaja, mbeten në fuqi në principatën e Shqipërisë. Ruajtja, ndryshimi ose heqja e imuniteteve dhe privilegjeve që u njihen të huajve në bazë të kapitulacioneve, i lihen një vendimi që mund të marrin të gjashtë Fuqitë e Mëdha.

5. Çdo person fizik apo juridik, qoftë i huaj, apo vendas mund të fitojë prona në Shqipëri, në përputhje me ligjet në fuqi dhe me ato që do të nxirren më vonë për këtë qëllim nga qeveria shqiptare.

Shteti shqiptar mund të ketë në dorë të blejë, të japë, të marrë me qira ose të shesë çdo lloj prone.

6. Pasuritë vakëf do të jenë objekt i rregullimit të një ligji të ri.

Kapitulli II

Sovrani

7. Froni i principatës shqiptare është i trashëgueshëm brenda në familjen e princit Vilhelm Vidi.

Trashëgimi bëhet në bazë të parimit të parëlindjes në vijën mashkullore.

8. Princi betohet para Asamblesë Kombëtare për të respektuar rreptësisht ligjet themeltare të shtetit.

9. Princi mbretëruës, si kryetar i familjes princore, ka të drejtën ekskluzive të ushtrojë autoritetin e vet në çdo gjë që ka të bëjë me marrëdhëniet personale të anëtarëve të familjes së tij, duke iu përmbajtur ligjit që ai do të nxjerrë vetë për dinastinë e tij.

10. Atij i lidhet një listë civile vjetore.

11. Në rast mungese, sëmundje ose paaftësie të përkohshme, princi ka të drejtë të përfaqësohet ose nga një anëtar i familjes së tij që ka shtetësinë shqiptare ose nga një funksionar i lartë i shtetit. Në rast miturie ose paaftësie që zgjat më tepër se një vit, regjenca do të ushtrohet nga njeri prej anëtarëve meshkuj të familjes princore, nga ai që, përveçse ka arritur madhori dhe ka shtetësinë e vendit, del se është më i afërti përta i përket trashëgimit të fronit. Në rast mungese të një zëvendësuesi të tillë, detyra për të përcaktuar regjentin do t'i lihet Këshillit të Ministrave, i cili duhet të veprojë me pëlqimin e gjashtë Fuqive të Mëdha. Në rast urgjence, kryetari i Këshillit të Ministrave do të jetë ligjërisht regjent i përkohshëm. Regjenti do të gëzojë, derisa të zgjasë regjenca e tij, të gjitha të drejtat dhe kompetencat e sovranit përta i përket qeverisjes së vendit.

12. Moshë e madhorisë për anëtarët e familjes princore do të caktohet nga ligji i shtëpisë mbretëruese.

13. Pasuritë e kurorës, që do të jenë pronë ekskluzive e shtëpisë princërore, do të jenë të përjashtuara nga taksat.

14. Princi është kryetar i administratës civile dhe ushtarake; ai disponon forcën e armatosur dhe emëron oficerët e saj. Ai merr pjesë në bërjen e ligjeve sipas dispozitave të kapitullit IV; vendimet e tij, të nxjerra dhe të botuara rregullisht quhen "dekrete" dhe duhet të kundërfirmohen nga Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe nga ministri kompetent.

15. Me propozimin e ministrave kompetentë, ai emëron funksionarë të lartë, por ai nuk mund të krijojë funksione të reja pa një ligj të posaçëm.

16. Ai thërret zgjedhësit për zgjedhjet e Asamblesë Kombëtare. Ai thërret, mbyll dhe shpërndan Asamblenë Kombëtare.

17. Drejtësia jepet në emër të tij; ai ka të drejtën e faljes dhe të amnistisë si dhe të drejtën ekskluzive për të dhënë çmime dhe tituj nderi.

18. Ai ka të drejtën të shtypë shëmbëlltyrën e tij ose stemën e tij në monedhat, në medaljet dhe në vulat shtetërore, si dhe në çdo send ose objekt që përfaqëson pushtetin qeveritar.

19. Ai përfundon traktate ndërkombëtare.

20. Personi i princit është i shenjtë. Ai nuk përgjigjet përpara ligjit.

21. Imunitetet e anëtarëve të familjes princore do të përcaktohen nga ligjet e ndryshme.

Kapitulli III

Popullsia

22. Janë shtetas shqiptarë të gjithë ata që kanë lindur ose që janë vendosur në Shqipëri përpara 28 nëntorit të 1912-s dhe që, nën qeverinë osmane kanë pasur nënshtetësinë osmane.

23. Personat, për të cilët bëhet fjalë në artikujt e mëparshëm, do të kenë mundësinë që brenda një afati prej gjashtë muajsh pas promulgimit të këtij statuti, të optojnë për një shtetësi të huaj, por me kusht që të emigrojnë.

24. Çdo person me prejardhje shqiptare që jeton jashtë vendit do të ketë mundësinë që, brenda një afati që do të caktohet nga qeveria, të konfirmojë shtetësinë e tij si shqiptar me anën e një deklarate me shkrim që duhet t'i paraqesë një autoriteti kompetent.

25. Shqiptarët, që kanë ardhur nga viset të cilat u janë aneksuar shteteve ballkanike dhe që janë vendosur me banim në principatën e Shqipërisë pas 28 nëntorit 1912, do të konsiderohen si shtetas shqiptarë; veçse në qoftë se ata nuk deklarojnë të kundërtën brenda gjashtë muajve që prej shpalljes së Statutit Organik.

26. Gjuha zyrtare e vendit është gjuha shqipe. Megjithatë, përdorimi i gjuhëve të tjera që fliten në vend, do të mund të lejohet, në trajtë ndihmëse dhe të përkohshme, në ato organe administrative që do të autorizohen posaçërisht për këtë nga qeveria.

27. Të gjithë shtetasit shqiptarë janë të barabartë përpara ligjit.

28. Asnjëri nuk mund të ushtrojë vetëgjyqësinë në çfarëdo forme qoftë, përndryshe do t'i nënshtrohet dënimit të parashikuar nga ligji.

29. Liria individuale është e garantuar. Asnjëri nuk mund të ndiqet, të burgoset ose të cenohet sadopak në lirinë e tij personale, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji dhe në format ligjore. Askush nuk mund të përjashtohet nga dalja përpara gjykatës së caktuar me ligj e as t'i nënshtrohet një dënimi të parashikuar nga ligji.

30. Banesa e çdo shtetasi shqiptar është e pacenueshme. Aty mund të hyhet me forcë vetëm në rastet dhe në format e parashikuara nga ligjet.

31. Çdo njeri është i lirë të zgjedhë vendbanimin e tij dhe të qarkullojë nëpër të gjithë vendin sipas kushteve që do të përcaktohen nga dispozitat e sigurimit publik.

32. Shqipëria nuk ka fe shtetërore. Liria dhe ushtrimi publik i të gjitha kulteve janë të siguruara. Në asnjë pjesë të principatës shqiptare, ndryshimi në fe nuk mund t'i vihet asnjëri si shkak për të përjashtuar ose për ta cilësuar si të paafte përsa i përket gëzimit të drejtave civile e politike, pranimit në punë shtetërore, në funksione ose ndere ose përsa i përket ushtrimit të profesioneve dhe aktiviteteve të ndryshme.

33. Të gjitha pasuritë e fituara ligjërisht janë të pacenueshme. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, veçse për shkak të dobisë publike në rastet e në format e përcaktuara nga ligjet dhe kundrejt një shpërblimi paraprak të drejtë.

34. Konfiskimi i pasurisë është i ndaluar.

35. Arsimi është i lirë. Nën mbikëqyrjen e qeverisë ai ushtrohet nga persona që kanë cilësitë e kërkuara nga ligji. Arsimi bëhet falas në shkollat fillore të shtetit. Arsimi fillor është i detyrueshëm për fëmijët shqiptarë kudo që ekzistojnë shkolla të shtetit. Mësimi i gjuhës shqipe është i detyrueshëm në të gjitha shkollat.

36. Secili është i lirë të shfaqë mendimet e tij gojarisht, me shkrim dhe nëpërmjet shtypit në përputhje me ligjet. Një ligj i posaçëm do të përcaktojë modalitetet e ushtrimit të kësaj lirie.

37. E drejta për t'u mbledhur, pa pasur me vete armë, u njihet të gjithë shtetasve shqiptarë, me kusht që këta t'u përshtaten ligjeve, që do të rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte. Kjo liri nuk zbatohet për mbledhjet në shesh të hapët, që u nënshtrohen ligjeve të mbikëqyrjes policore.

38. Shtetasit shqiptarë kanë të drejtën të krijojnë shoqata, po me kusht që në qëllimet dhe në mjetet e tyre të mos ketë asgjë të paligjshme dhe të rrezikshme për shtetin. Një

ligj i posaçëm do të rregullojë ushtrimin e kësaj të drejte, me qëllim që të garantohet siguria publike.

39. Me përjashtim të rasteve të caktuara me ligj, fshehtësia e letrave dhe e telegrameve është e paprekshme. Një ligj i posaçëm do të përcaktojë përgjegjësinë e nëpunësve qeveritarë për cenimin e fshehtësisë së letrave dhe të telegrameve, që u bëhen personave të postës dhe të telegrafit.

Kapitulli IV

Legjislacioni

40. Asambleja Kombëtare është organi legjislativ i principatës së Shqipërisë.

41. Asambleja Kombëtare përbëhet nga:

- 1) anëtarë në bazë ligji;
- 2) anëtarë të zgjedhur nga popullsia;
- 3) anëtarë të caktuar nga princi.

42. Janë vetvetiu anëtarë (në bazë ligji) të Asamblesë: përfaqësuesit fetarë të myslimanëve, të katolikëve, të ortodoksëve, kryetari i bektashinjve, komisari i lartë shqiptar pranë Bankës Kombëtare Shqiptare.

43. Që një njeri të zgjidhet ose të caktohet si anëtar i Asamblesë Kombëtare, ai duhet të ketë nënshtetësinë shqiptare dhe vendbanim brenda kufijve të principatës.

44. Anëtarët e zgjedhur të Asamblesë Kombëtare zgjidhen me votim indirekt nga tre për çdo sanxhak. Princi cakton datën e zgjedhjeve.

45. Kur mbeten vende vakante, për shkak dorëheqjeje apo vdekjeje, anëtarët e zgjedhur ose të caktuar për të zënë këto vende, mund t'i mbajnë ato vetëm për aq kohë sa do të zgjasë mandati i paraardhësve të tyre.

46. Të gjithë anëtarët e Asamblesë Kombëtare marrin gjatë kohës që vazhdon sesioni për udhëtimin, vajtje e ardhje, një shpërblim prej 15 frangash në ditë. Ky shpërblim nuk jepet në raste mungese në seancat.

47. Anëtarët e Asamblesë Kombëtare që emërohen nga princi janë dhjetë.

48. Në nahijet këshilli komunal, i mbledhur nën kryesinë e mudirit, do të zgjedhë një delegat. Ky do të shkojë në kryeqendrën e kazasë dhe do të bashkohet me anëtarët e

këshillit bashkiak dhe të këshillit të kazasë. Nën kryesinë e kajmekamit ky trup elektoral do të zgjedhë dy delegatë, të cilët do të shkojnë në qendrën e sanxhakut dhe nën kryesinë e mytesarifit, do të zgjedhin me shumicë absolute përfaqësuesit për në Asamblesë Kombëtare.

Kajmekami, mytesarifi dhe të gjithë funksionarët e emëruar nga qeveria nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në votim. Detyra e mytesarifit dhe e kajmekamit është vetëm të kryesojnë mbledhjen elektorale dhe të mbikëqyrin respektimin e rregullave përkatëse.

Në qoftë se dy kandidatë marrin një numër të barabartë votash atëherë zgjedhja bëhet me short.

49. Mund të zgjidhen si anëtarë të Asamblesë Kombëtare shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 30 vjeç dhe që dinë të lexojnë e të shkruajnë.

50. Nënpunësit e emëruar nga princi dhe nga qeveria nuk mund të zgjidhen si anëtarë të Asamblesë Kombëtare gjatë gjithë kohës që zgjatin funksionet e tyre.

51. Çdo zgjedhje për të qenë e vlefshme duhet të marrë vërtetimin e Asamblesë Kombëtare.

52. Asambleja Kombëtare mblidhet rregullisht në sesion të zakonshëm çdo vit. Ajo thirret, shtyhet (ndërpritet), mbyllet nga princi.

53. Kohëzgjatja e legjislaturës është katër vjet.

54. Asambleja Kombëtare mund të thirret në sesion të jashtëzakonshëm nga princi.

Fillimi dhe mbarimi i sesionit të jashtëzakonshëm, si dhe arsyet (e thirrjes së saj), fiksohen në vendimin e thirrjes.

55. Princi ka të drejtë të shpërndajë Asamblesë Kombëtare.

Akti i shpërndarjes parashikon edhe thirrjen e zgjedhësve brenda dyzet ditëve.

56. Në fillim të çdo legjislature dhe gjatë gjithë kohës që ajo zgjat, princi zgjedh një kryetar midis anëtarëve të Asamblesë Kombëtare.

Kryetari do të marrë një shpërblim vjetor të përgjithshëm prej 10.000 frangash. Asambleja Kombëtare ka dy nënkryetarë, që zgjidhen prej saj për gjithë kohën që zgjat legjislatura, menjëherë pasi fillon nga detyra Kryetari.

57. Me propozimin e Kryetarit të Asamblesë Kombëtare, princi do emërojë dy sekretarë që do të merren jashtë radhëve të Asamblesë. Ata do të kenë një rrogë vjetore prej 6.000 frangash.

58. Që Asambleja të mund të marrë vendime të vlefshme është e domosdoshme që të jenë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të saj. Vendimet merren me shumicën absolute të votave të anëtarëve të pranishëm.

Në rast se votat ndahen në dysh, propozimi i shqyrtuar quhet i hedhur poshtë.

Një shumicë prej pesë të tetash është e domosdoshme kur është fjala për të votuar një ligj, i cili sjell ndryshime një ligji themelor të principatës.

Për zgjedhjet që bëhen brenda për brenda Asamblesë, shumica absolute është e domosdoshme në votimi e parë; në votimin e dytë mjafton shumica relative.

59. Çdo anëtar i Asamblesë voton vetë personalisht. Votimi bëhet ose duke u ngritur në këmbë e duke u ulur, ose me thirrje nominale.

60. Një projektligj mund të adoptohet vetëm pasi të vihen në votë të gjithë nenet që e përbëjnë.

61. Rendi i brendshëm i Asamblesë sigurohet nga Kryetari i saj, sipas rregullores së brendshme.

Asnjëri, me përjashtim të agjentëve të forcës publike që janë ngarkuar të ruajnë Asamblenë, nuk mund të hyjë me armë brenda godinës që është rezervuar për mbledhje.

62. Seancat e Asamblesë Kombëtare janë publike. Peticionet duhet t'i paraqiten kryetarit ose drejtpërsëdrejti, ose nëpërmjet njërit prej anëtarëve të Asamblesë Kombëtare.

63. Asambleja mund të bëjë mbledhje të fshehta kurdoherë që këtë e kërkojnë të paktën një e treta e anëtarëve të pranishëm.

64. Anëtarët e Asamblesë, të çfarëdo kategorie qofshin, kanë të njëjtat të drejta, të njëjtat prerogativa dhe të njëjtat detyra. Ata janë të lirë të japin votat e tyre ose të abstenojnë, si dhe të shfaqin mendimet e tyre. Ata nuk mund të ndiqen për shkak të fjalimeve të tyre, të propozimeve që mund të bëjnë me shkrim ose të raporteve që mund të adaptojnë, veçse në ato raste kur këtë e kërkojnë gjashtë anëtarë, të cilët janë të detyruar të provojnë se fjalimi i mbajtur apo propozimi apo raporti i shkruar përmban një krim të parashikuar nga ligji. Ndjekja duhet të autorizohet nga Asambleja.

Asnjë ndjekje penale për faktet që s'kanë të bëjnë me funksionet e tyre, nuk mund të bëhet kundrejt anëtarëve gjatë kohës së sesionit, veçse në rast se ajo autorizohet nga Asambleja me kërkesën e prokurorit pranë gjykatës kompetente.

65. Asambleja përgatit dhe voton rregulloren e saj të brendshme.

66. Për fjalimet, për vërejtjet, për mocionet e tyre dhe për çdo shkrim që ka të bëjë me ushtrimin e funksioneve të tyre, anëtarët e Asamblesë Kombëtare duhet të përdorin gjuhën shqipe.

67. Në kuadrin e pushtetit legjislativ të Asamblesë hyjnë:

1) çdo ndryshim i ligjeve themelore të principatës;

2) ligjet që ndryshojnë ose shndërrojnë taksat ekzistuese;

3) ligjet që vendosin taksa të reja;

4) ligjet e buxhetit dhe ato që miratojnë llogaritë e një viti buxhetor të mbyllur, duke marrë parasysh marrëveshjet ndërkombëtare që mund të lidhen;

5) ligjet mbi kontribucionet indirekte;

6) traktatet e tregtisë dhe marrëveshjet me karakter ekonomik;

7) koncesionet që angazhojnë burimet e shtetit;

8) ndarjen administrative.

Të gjitha vendimet që merr Asambleja Kombëtare në fushën legjislative duhet t'i nënshtrohen princit për sanksionim.

68. Për të gjitha fushat e tjera princi, me propozimin e qeverisë, nxjerr dekrete që kanë forcën e ligjit. Ai mund të konsultojë asamblenë Kombëtare kurdoherë që e quan të nevojshme.

69. Në fillim të çdo sesioni të zakonshëm vjetor projekti i buxhetit për vitin vijues i paraqitet Asamblesë Kombëtare nga ministri i Financave.

Së bashku me këtë projekt, ministri i Financave i paraqet Asamblesë Kombëtare buxhetin rektifikativ të vitit buxhetor të mbyllur. Në qoftë se buxheti rektifikativ nuk hartohet në kohë, ai duhet të paraqitet, jo më vonë se në sesionin vijues.

70. Në qoftë se Asambleja pakëson ndonjë kredi të propozuar ose e suprimon fare, ajo duhet të japë shpjegime për votën e saj dhe të tregojë ku dhe si mund të realizohet kursimi.

71. Në qoftë se Asambleja, pasi ka dëgjuar shpjegimet, ose në qoftë se ajo arrin në fund të sesionit pa votuar buxhetin, princi me një urdhëresë që nxjerr pasi ka marrë një mundim të njëllojtë edhe nga Këshilli i Ministrave, mund ta bëjë buxhetin në vazhdim të

zbatueshëm edhe për vitin buxhetor vijues, por duke zbritur shumat e parashikuara për një nevojë të caktuar, kur kjo është plotësuar.

Kapitulli V

Organet e qeverisë

A) Ministrinë dhe ministrat

72. Qeveria shqiptare përbëhet nga një Këshill Ministrash në krye të të cilit është një kryeministër.

Në rast mungese dhe paafësie të kryeministrit, Këshilli thirret dhe kryesohet prej ministrit më të vjetër në moshë.

73. Ministrinë janë këto:

Ministria e Punëve të Jashtme,

Ministria e Punëve të Brendshme,

Ministria e Financave,

Ministria e Drejtësisë.

74. Kryetari i Këshillit është në të njëjtën kohë ministër i punëve të Jashtme.

75. Çdo ministri i caktohet si ndihmës një sekretar i përgjithshëm.

76. Të gjithë ministrat emërohen nga princi, atij i bëhet betimi dhe në çdo rast dorëheqjeje, atij i dorëzohet pushteti.

77. Çdo ministri ndahet në departamente të kryesuara nga drejtorë të përgjithshëm. Çdo departament është i ndarë në seksione.

78. Ministria e Punëve të Brendshme ka pesë departamente: 1) administrata; 2) xhandarmëria dhe milicia; 3) bujqësia, tregtia, lundrimi dhe industria; 4) posta dhe telegrafi; 5) shëndetësia.

79. Ministria e Financave ndahet në pesë departamente: 1) thesari dhe huaja publike; 2) doganat; 3) taksat, kontributet dhe monopolet; 4) llogaria e përgjithshme e shtetit; 5) punët botërore.

80. Ministria e Drejtësisë ndahet në tri departamente: 1) drejtësia; 2) kultet (fetare); arsimiti.

81. Çdo ligj që krijon një shërbim (publik) të ri duhet të përcaktojë edhe ministrinë si dhe departamentin ku do të hyjë ky shërbim.

82. Këshilli i Ministrave harton projektligjet, dekretet princore, si dhe urdhëresat administrative të interesit të përgjithshëm; ai shfaq mendimin e vet mbi çështjet që i shtrohen nga princi dhe nga ministrat e ndryshëm.

83. Shkarkimi i sekretarëve dhe i drejtorëve të përgjithshëm, si dhe i shefave të seksioneve mund të bëhet vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave sipas propozimit të ministrit kompetent.

84. Ministrat përgjigjen përpara princit.

Një ligj i posaçëm do të përcaktojë procedurën që do të ndiqet në rast shpërdorimi të pushtetit.

85. Anëtarët e familjes princore nuk mund të emërohen ministra.

B. Organizimi i shërbimit të shtetit.

86. Çdo person i ngarkuar me një shërbim që i përket shtetit konsiderohet si nëpunës i shtetit.

87. Të gjitha emërimet e nëpunësve bëhen në përputhje me rregullat që përcaktojnë edhe kushtet përkatëse.

88. Çdo nëpunës, para se të fillojë nga kryerja e detyrave të tij, duhet të bëjë betimin e besnikërisë dhe të respektit ndaj princit dhe ligjeve të vendit.

89. Çdo nëpunës që jep prova sjelljeje të mirë, ndershmërie dhe aftësie në kryerjen e detyrave të tij, ka të drejtën e gradimit dhe të shpërblimeve të tjera sipas dispozitave që do të përcaktohen me rregullore të posaçme.

90. Çdo nëpunës duhet të përmbushë me ndërgjegje detyrat që i janë besuar; ai duhet të ruajë fshehtësinë profesionale dhe t'u bindet urdhërave të eprorëve të tij, me kusht që këto urdhëra të jenë brenda caqeve të vendosura nga ligji.

91. Çdo nëpunës që shkel betimin dhe nuk i kryen detyrat, mund të shkarkohet dhe të ndëshkohet sipas dispozitave dhe me garancitë që caktohen nga ligjet.

92. Ndëshkimet disiplinore, përveç rasteve që hyjnë në kompetencën e gjykatave të zakonshme, duhet të zbatohen sipas rregulloreve të brendshme të çdo ministrie. Ato janë: qortimi, pezullimi i funksioneve dhe i rrogës, shkarkimi.

93. Në rast grumbullimi të detyrave shtetërore nëpunësi do të marrë vetëm shpërblimin më të lartë që parashikohet për këto detyra.

94. Nëpunësit që merren në punë me kontratë nuk kanë të drejta të tjera kundrejt shtetit veç atyre që rrjedhin nga kontrata.

Kapitulli VI

Administrata lokale

97. Shqipëria ndahet në shtatë sanxhaqe, që janë: Shkodra, Elbasani, Dibra, Durrësi, Berati, Korça dhe Gjirokastra.

98. Kryeqendrat e këtyre sanxhaqeve janë qytetet, emrat e të cilave mbajnë sanxhaqet vetë, me përjashtim të sanxhakut të Dibrës, kryeqendra e të cilit do të caktohet nga qeveria.

97. Sanxhaqet ndahen në kaza dhe kazatë në nahije.

98. Kufijtë e sanxhaqeve caktohen me ligj. Në caktimin e këtyre kufijve ligji merr parasysh nevojat administrative, interesat lokale dhe lehtësitë e komunikacionit. Projektligji i lidhur me caktimin e kufijve administrativë duhet të paraqitet nga Ministria e Brendshme në sesionin e parë të Asamblesë Kombëtare. Deri atëherë, kufijtë mbeten përkohësisht ato që kanë qenë nën administratën otomane, veç kur një dekret i princit vendos ndryshe. Ndërkaq sanxhaku i Dibrës do të përbëhet nga pjesa që mbetet prej sanxhakut të vjetër të Dibrës dhe nga tokat e vilajetit të Kosovës që iu caktuan Shqipërisë.

Për sa u përket krahinave të Jugut, kazaja e Leskovikut, që varej më parë nga sanxhaku i Janinës, do të futet në sanxhakun e Korçës, kurse fshatrat e Çamërisë, që i mbeten Shqipërisë, do të futen në sanxhakun e Gjirokastrës.

99. Kufijtë (e njësive administrative) mund të ndryshohen vetëm me një ligj të ri.

Sanxhaqet

100. Sanxhaku administrohet nga një mytesarif, i cili për të gjitha çështjet administrative përgjigjet përpara ministrit të Brendshëm dhe përpara ministrave kompetentë për të gjitha çështjet e tjera.

101. Në rast mungese, ai ia lë drejtimin e punëve njerit prej anëtarëve të këshillit të tij, në radhë të parë më të vjetrit në moshë ndërmjet anëtarëve që janë caktuar me ligj. Në rast pushimi të zakonshëm, i takon Ministrisë së Brendshme të zgjedhë zëvendësin e mytesarifit.

102. Ai ka nën varësinë e tij të drejtpërdrejtë xhandarmërinë dhe policinë.

103. Në bashkëpunim me këshillin e tij, ai cakton buxhetin e sanxhakat të tij dhe ia parashtron qeverisë qendrore.

104. Ai duhet të inspektojë një herë në vit të gjitha kazatë që ndodhen nën administrimin e tij.

105. Ai është përgjegjës bashkë me kryellogaritarin për drejtimin e financave të sanxhakat të tij. Për këtë qëllim, ai mund të kontrollojë, kurdoherë që e gjykon të nevojshme, arkat e sanxhakat dhe të kazasë.

106. Duke qenë personalisht përgjegjës për qetësinë publike, ai mund të marrë, në rast ngutësie absolute, masa të jashtëzakonshme sigurimi, por me kusht që të vërë menjëherë në dijeni për këto qeverinë qendrore.

107. Meqenëse gjykatat janë të pavarura nga administrata civile, mytesarifit në asnjë mënyrë nuk mund të përzihet në çështjet gjyqësore. Por ai ka për detyrë të japë ndihmën dhe mbështetjen e duhur për ekzekutimin e vendimeve.

108. Zbatimi i ligjeve dhe i dekreteve që kanë të bëjnë me arsimin publik dhe me inspektimin e të gjitha institucioneve shkollore hyjnë në kompetencën e mytesarifit.

Këshilli i sanxhakat

109. Mytesarifit ndihmohet nga një këshill që quhet këshilli i sanxhakat dhe që është nën kryesinë e tij.

110. Ky këshilli përbëhet: 1) nga anëtarë të caktuar me ligj (sekretari i përgjithshëm, kryellogaritari, drejtori i arsimit publik, drejtori i punimeve botore, drejtori i bujqësisë dhe i tregtisë) dhe 2) nga anëtarë të zgjedhur (një për çdo kaza, duke përfshirë edhe kazanë qendrore).

111. Zgjedhjet janë indirekte dhe bëhen sipas shembullit të zgjedhjeve të anëtarëve të Asamblesë Kombëtare.

112. Funkcionet e anëtarëve të zgjedhur zgjasin tre vjet. Këta mund të rizgjidhen.

113. Këshilli mbledhet tre muaj çdo vit, në kryeqendrën e sanxhakat. Në rast nevoje, mytesarifi mund të zgjasë sesionin edhe për një muaj tjetër.

114. Anëtarët e zgjedhur marrin një shpërblim prej dyqind frangash në muaj gjatë kohës së sesionit.

115. Vendimet merren me shumicë votash. Kur votat ndahen barabar, vendos vota e kryetarit.

116. Mytasarifi nuk mund të shtyjë zbatimin e një vendimi të marrë me shumicë votash, veçse nën përgjegjësinë e tij personale dhe me kusht që ai të vërë menjëherë në dijeni ministrinë kompetente.

117. Çështjet që i përkasin vetëm e vetëm këshillit të sanxhakat të mbledhur në sesionin plenar, janë:

- . hartimi i buxhetit të sanxhakat;
- . kontrolli i administrimit të financave;
- . rishikimi i caktimit dhe i vjeljes së taksave dhe të tatimeve;
- . hapja dhe funksionimi i institucioneve shkollore, përmirësimet që duhen bërë në to;
- . studimi i projekteve, i planeve dhe i preventivave të punëve botore që duhen zbatuar brënda kufijve të sanxhakat dhe që duhet t'i parashtrohen qeverisë qendrore për miratim;
- . shërbimet e qarkullimit e të transportit;
- . përmirësimi i bujqësisë dhe i blegtorisë;
- . prerja e drurëve në pyjet që u përkasin komunave (baltaliqet e vjetra).
- . ripyllëzimi i vendit.
- . votimi për qindarkat që mund t'u shtohen taksave dhe tatimeve me kusht që të merret pëlqimi i qeverisë.
- . ngritja dhe mirëmbajtja e spitaleve dhe e institucioneve bamirëse.
- . vendosja e stabilimenteve industriale e të tjerë.
- . shfrytëzimi i mademeve.

118. Të gjitha çështjet e tjera mund të trajtohen e të vendosen nga mytesarifi së bashku me anëtarë të përhershëm të këshillit.

Kazatë

119. Kazaja administrohet nga një kajmekam. Në rast mungese ai ia lë drejtimin e punëve njërit prej anëtarëve të këshillit të tij, në radhë të parë më të vjetrit në moshë ndërmjet anëtarëve të caktuar në bazë ligji. Në rast pushimi të zakonshëm i takon mytesarifit të zgjedhë zëvendësin e tij.

120. Kajmekami ngarkohet me ruajtjen e rendit publik e të qetësisë. Për këtë qëllim ai ka nën urdhrat e tij policinë dhe xhandarmërinë. Në qoftë se forcat që ndodhen në kaza janë të pamjaftueshme, ai mund t' i kërkojë, po qe nevoja, përforcime mytesarifit.

121. Financat e kazasë i besohen një llogaritari. Kajmekami është përgjegjës për financat e kazasë me të njejtat të drejta dhe me të njejtat kushte sikurse mytesarifi në sanxhak.

122. Njësoj si mytesarifi, kajmekami nuk ka të drejtë të përzihet në çështjet gjyqësore.

123. Kajmekami vendos për çështjet që vijojnë:

lëshimi i pasaportave;

lëshimi i lejeve për gjueti dhe për mbajtjen e armëve;

legalizimi i nënshkrimeve të autoriteteve të kazasë;

autorizimi i vënies në qarkullim i shërbimeve publike të transportit;

autorizimi i vendshitjeve të pijeve pas mendimit të favorshëm të bashkisë;

Këshilli i kazasë

124. Kajmekami ndihmohet nga një këshilli që quhet këshilli i kazasë dhe që është nën kryesinë e tij.

125. Këshilli përbëhet: 1) nga anëtarë të caktuar në bazë ligji (sekretari, llogaritari, drejtori i tatimeve mbi tokat) dhe 2) nga katër anëtarë që zgjidhen, me shumicën absolute të votueve të pranishëm, prej këshillave komunale që mblidhen në kryeqendrën e kazasë me thirrje të kajmekamit.

126. Funksionet e anëtarëve të zgjedhur zgjasin tre vjet. Këta mund të rizgjidhen.

127. Këshilli funksionon gjithë vitin. Ai mbledhet të paktën një herë në javë.

128. Anëtarët e zgjedhur nuk marrin as rrogë, as shpërblim.

129. Vendimet merren me shumicën e votave. Kur votat ndahen barabar, vendos vota e kryetarit.

130. Kajmekami nuk mund të shtyjë zbatimin e një vendimi të marrë me shumicë votash, veçse nën përgjegjësinë e tij personale dhe me kusht që ai të vërë menjëherë në dijeni mytesarifin prej të cilit varet.

131. Çështjet që i përkasin vetëm e vetëm këshillit të kazasë janë homologimi (miratimi) i tarifave për të drejtën e vendit në pazaret, në panairt dhe në tregjet;

homologimi i tarifave të taksave të peshimit, të vëllimit dhe të matjes;

autorizimi i aksioneve për asgjësimin e kafshëve të dëmshme në pyjet e komunave;

kontrolli i buxhetit dhe i llogarive të institucioneve bamirëse dhe i administrimit të pasurive të tyre; autorizimi i pranimit të dhuratave dhe legeve për komunat dhe institucionet bamirëse;

Nahijet

135. Nahija përbëhet nga një grup fshatrash të lidhura gjeografikisht dhe ekonomikisht, me një popullsi globale prej 4000 - 7000 frymësh.

136. Çdo nahije administrohet nga një mudir, që ndihmohet prej një këshilli komunal.

137. Këshilli komunal përbëhet nga sekretari i nahijes dhe nga katër anëtarë të zgjedhur.

Zgjedhjet bëhen me shumicën e votave nga muhtarët e fshatrave që përbëjnë nahijen, të mbledhur në kryeqendrën e nahijes nën kryesinë e muhtarit të kryeqendrës.

135. Mudiri ka si detyra:

botimin dhe zbatimin e ligjeve, të dekreteve, të vendimeve dhe të urdhëresave të qeverisë;

regjistrimin e popullsisë;

kontrollin e vjeljes së taksave dhe të tatimeve.

136. Këshilli vendos për çështjet që vijnë:

çështje të higjienës publike;

rrugët e komunikacionit midis fshatrave;

mirëmbajtja e çezmave, e puseve, e cisternave, e ujësjellësve, përmirësimi i vijave të ujit;

ujitja e tokave të punuara, kanalet vaditëse, digat;

përmirësimi i bujqësisë dhe i blegtorisë;
kullotat komunale.

139. Hollësitë e kompetencave të mësipërme, si dhe të gjitha kompetencat e tjera të mytesarifëve, të kajmekamëve, të mudirëve dhe të këshillave pranë tyre; do të përcaktohen me rregullore të posaçme. Derisa të hartohen këto rregullore, administrata lokale do të vazhdojë të funksionojë si në të kaluarën.

140. Për sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtën për t'u zgjedhur, ligjet ekzistuese do të mbahen përkohësisht në fuqi, derisa të dalë një ligj i ri.

Bashkitë

141. Në kryeqendrat e sanxhaqeve e të kazave do të ketë një bashki, sikurse edhe në çdo qytet me një popullsi prej më tepër se 2500 frymësh.

142. Ligjet që rregullojnë funksionimin e bashkive do të mbeten në fuqi derisa të dalë një ligj i ri.

Kapitulli VII

Financat

144. Administrata e financave dhe degët që varen prej saj do të organizohen sipas rregulloreve të posaçme. Ndërkohë, organizimi i mëparshëm i financave do të vazhdojë të jetë në fuqi, me ndryshime të një rëndësie të dorës së dytë, që mund t'i bëhen me dekret princor.

145. Asnjë ngarkim fiskal, veç atyre që ekzistojnë; nuk mund të vihet pa ligj.

146. Asnjë shpenzim nuk mund të bëhet po qe se ai nuk është parashikuar nga buxheti. Në rast nevoje të ngutshme, princi pasi merr edhe mendimin e Këshillit të Ministrave, mund të nxjerrë një dekret shpenzimi të jashtëzakonshëm, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare që mund të lidhen eventualisht. Në sesionin e parë të Asamblesë Kombëtare ky shpenzim duhet t'i parashtrahet Asamblesë për konfirmim.

Kapitulli VIII

Punët botore

144. Departamenti i punëve botore do të ketë veç drejtorit të përgjithshëm, një arkitekt, një inxhinier urash e rrugësh dhe një ekspert për punimet e kanalizimit e të tharjes. Këta nëpunës, të cilëve ministria mund t'u shtojë çdo specialist tjetër që do ta gjykojë të nevojshëm, do të formojnë këshillin e përhershëm të seksionit.

145. Punimet me dobi publike mund të kryhen drejtpërdrejt nga qeveria ose mund t' u jepen koncesion sipërmarrjeve private.

146. Projektet e rrugëve, që duhet të ndërtohen nga qeveria, përpilohen nga departamenti i mësipërm; ato të rrugëve krahinore nga këshillat e sanxhaqeve dhe ato të udhëve që lidhin fshatrat nga këshillat e komunave. Në të dyja rastet e fundit projektet e përpiluara në këtë mënyrë duhet t'i dërgohen për miratim departamentit të punëve botore, i cili do të mbikëqyrë zbatimin.

147. Shpenzimet e ndërtimit dhe të mirëmbajtjes së rrugëve kombëtare dhe krahinore hyjnë në buxhetin e shtetit. Ato të udhëve të fshatrave janë në ngarkim të komunave, të cilat mund të autorizohen nga këshillat e sanxhaqeve që të vendosin taksa kalimi në rastet kur burimet e tyre janë të pamjaftueshme. Këto taksa kalimi mund të mbahen vetëm për aq kohë sa do ta gjykojë të nevojshme këshilli.

148. Mbikëqyrja e ndërtimit, si dhe e shërbimit të hekurudhave, që do të ndërtohen në Shqipëri, qoftë nga shteti vetë apo nga shoqëri koncesionare, janë në kompetencën e departamentit të punëve botore, i cili, në rast nevojë mund të marrë si bashkëpunëtorë inxhinierë specialistë.

Kapitulli IX

Forcat e Armatosura

149. Forca e armatosur përbëhet prej xhandarmërisë dhe prej milicisë.

A) Xhandarmëria

150. Meqenëse organizimin e xhandarmërisë Fuqitë e Mëdha ia kanë besuar Misionit Holandez, ky i fundit do të hartojë rregulloren përkatëse. Kjo rregullore do të hyjë në fuqi vetëm pasi të miratohet nga princi.

B. Milicia

151. Milicia është një forcë ushtarake vendase territoriale dhe sedentare. Ajo zë vend zakonisht në qendrat e saj dhe nuk mund të mobilizohet tërësisht ose pjesërisht veçse me dekret të princit.

152. Milicia ka për detyrë në kohë paqeje të mbështetë eventualisht veprimet e xhandarmërisë për ruajtjen e rendit publik brënda vendit.

153. Çdo banor vendas i principatës është i detyruar të kryejë personalisht shërbimin ushtarak në radhët e milicisë dhe të rezervës së saj.

154. Zëvendësimet nuk lejohen.

155. Përfshihen përgjithnjë nga shërbimi vetëm ata që janë fizikisht të paaftë.

156. Formimi dhe organizimi i milicisë do të jetë objekt i një ligji të veçantë.

157. Në rast se organizimi i milicisë shtron nevojën e përdorimit të oficerëve të huaj, kufizimi i parashikuar nga Konferenca e Londrës përta i përket përdorimit të oficerëve për organizimin e xhandarmërisë, vlen edhe për milicinë; përjashtim mund të bëhet vetëm në marrëveshje midis qeverisë princore dhe Fuqive të Mëdha.

158. Në rast nevoje, princi, me dekret të posaçëm, mund të rekuizojë kafshët e barrës dhe mjetet e transportit, si dhe ushqimet, brënda kufijve dhe me kushtet e përcaktuara në të njëjtin dekret.

Kapitulli X

Drejtësia

159. Autoritetet gjyqësore janë: 1) këshilli i pleqve; 2) gjykatësit paqtues; 3) gjykatat e shkallës së parë; 4) gjykatat e apelit.

160. Këshilli i pleqve ndodhet në çdo fshat, formohet sipas ligjit. Ai është kompetent për rastet që rrjedhin nga dëmet që bëhen në fshat të cilat shkaktojnë një gjobitje prej dhjetë deri në njëqind franga.

161. Gjykatësit e paqit do të emërohen me dekret princor. Ata do të vendosen në vendet që do të caktohen me dekret ministror; ata janë kompetentë të gjykojnë në fushën civile, pa apel, grindjet për shuma prej 100 deri 500 franga; në fushën penale, ata shqyrtojnë shkeljet e dënueshme me burgim njëzet e katër orësh deri në një javë, pa apel dhe prej një jave deri në tre muaj, me apel.

162. Gjykatat e shkallës së parë do të ngrihen në çdo sanxhak, si dhe ato kaza ku do të shihet nevoja. Ato do të përbëhen nga një kryetar, dy ndihmësgjyqtarë, një prokuror, një gjyqtar hetues, dy sekretarë dhe dy ftues.

163. Në fushën civile këto gjykata do të kenë kompetencë të gjykojnë, pa apel, të gjitha çështjet që kapin vlerën prej më se 500 frangash deri në 1000 frangash dhe me apel të gjitha çështjet e tjera. Për çështjet tregtare, këto gjykata do të shndërrohen, sikur se nën regjimin otoman, në gjykata tregtie. Në fushën penale, ato do të gjykojnë të gjitha krimet dhe kundërvajtjet. Veç asaj, ato do të gjykojnë në shkallë të dytë çështjet që vijnë nga gjykatësit e paqit.

164. Do të ketë tri gjykata apeli, selitë e të cilave do të caktohen nga qeveria. Ato do të përbëhen nga një kryetar, katër këshilltarë, një prokuror, një zëvendësprokuror, dy kancelarë, një sekretar dhe dy ftues.

Ato janë kompetente të gjykojnë në shkallë të dytë të gjitha çështjet civile e penale të gjykuara nga gjykatat e instancës së parë.

165. Gjyqtarët janë të palëvizshëm. Kushtet që duhet të plotësojnë gjyqtarët e të gjitha kategorive lidhur me emërimin, me gradimin e tyre do të trajtohen në një ligj të posaçëm.

166. Veç kompetencave që parashikohen nga ky statut, gjykatësit e paqit, gjykatat e instancës së parë dhe gjykatat e apelit mund të kenë edhe detyra të tjera që mund t'u ngarkohen nga ligje të ndryshme.

167. Një ligj i veçantë do të përcaktojë krijimin dhe detyrat e noterisë.

168. Ngritja e një gjykate më të lartë se gjykata e apelit, si dhe e çdo gjykate tjetër të posaçme lihet në gjykimin e princit dhe të qeverisë së tij.

169. Prokurori dhe zëvendësi i tij e zhvillojnë veprimtarinë publike në të gjithë sferën e juridiksionit të gjykatës. Ata kujdesen për ruajtjen e rendit në gjykatat dhe për zbatimin e vendimeve që janë dhënë. Mbikëqyrja e policisë gjyqësore u takon atyre.

Në fushën civile prokurori vepron sa herë që këtë e kërkojnë interesat e ligjit. Ai merr pjesë në seancat dhe jep konkluzionet e tij.

Prerogativat e konsullatave në fushën gjyqësore ruhen ashtu siç rrjedhin nga kapitulacionet.

Kapitulli XI

Kultet

170. Të gjitha komunitetet fetare shqiptare ekzistuese njihen (nga shteti). Ky parim zbatohet edhe për sektet e ndryshme myslimane. Asnjë pengesë nuk duhet të nxirret për organizimin hierarkik të komuniteteve të ndryshme e as për marrëdhëniet që këto mund të kenë në çështje të dogmës fetare, me kryetarët e tyre shpirtërorë më të lartë.

171. Komunitetet fetare në Shqipëri do të ruajnë pasuritë e tyre.

172. Komunitetet do të vazhdojnë të marrin, nën mbrojtjen e autoriteteve, të ardhurat e konsakruara nga zakoni.

173. Përjashtohen nga taksat godinat që shërbejnë për kultet, për arsimin publik dhe për veprat bamirëse.

174. Në rast se formohen komunitete fetare të reja të kulteve të ndryshme, shteti rezervon të drejtën t'i njohë dhe të përcaktojë të drejtat e tyre.

175. Klerikët dhe paria e të gjitha komuniteteve fetare të njohura prej shtetit do të marrin investiturën nga lartësia e tij princi.

176. Rregullimi i marrëdhënieve midis kishave ekzistuese në Shqipëri dhe kryetarëve të tyre shpirtërorë më të lartë do të jetë objekt i marrëveshjeve të posaçme që do të lidhen midis qeverisë shqiptare dhe këtyre krerëve.

177. Shteti duhet të marrë masa për mbajtjen e të gjitha kulteve të njohura, si dhe të klerit duke caktuar për këtë qëllim shumën që do të gjykojë të nevojshme në buxhetin e përgjithshëm shtetëror; do të ketë parasysh edhe pasuritë e patundshme që kanë aktualisht këto kulte.

Kapitulli XII

Arsimi publik

178. Mbajtja e shkollave të shtetit dhe e shkollave të komuniteteve shqiptare është në ngarkim të shtetit. Një ligj i posaçëm do të rregullojë funksionimin e këtyre shkollave.

179. Në shkollat vendase mësimi në gjuhën shqipe është i detyrueshëm. Por mësimi fetar mund të bëhet vetëm në gjuhën e kultit.

180. Mësuesit e gjuhëve të huaja mund të jenë shtetas të huaj. Të gjithë të tjerët duhet të jenë shtetas shqiptarë, me përjashtim të rasteve, kur ka një autorizim të posaçëm të qeverisë.

181. Ngritja dhe funksionimi i shkollave teologjike, të mjeshtërive dhe të zanateve të arteve të bukura, si dhe i çdo arsimit teknik do të rregullohen me ligje të posaçme.

182. Qeveria mbikëqyr funksionimin e të gjitha institucioneve shkollore dhe respektimin e ligjeve përkatëse.

Kapitulli XIII

Prona tokësore

183. Në Shqipëri pronat e patundshme ndahen në pronat private, në pronat publike dhe në pasuri të dhuruara.

184. Pronat private janë ato që u përkasin një ose më shumë personave si dhe personave juridikë. Çdo zotërim duhet të provohet me dokumente zyrtare ose me çdo mjet tjetër të parashikuar nga ligji otoman mbi tokat.

185. Pronat publike ose shtetërore janë dy llojesh; ato për të cilat shteti e ka mbajtur vetë të drejtën e shfrytëzimit dhe ato për të cilat shteti u ka dhënë të drejtën mbi të ardhurat e komunave të ndryshme (si p.sh. baltatik ose e drejta e prerjes së drurëve, merá ose e drejta e kullotjes).

186. Pasuritë “e dhuruara” ose vakëfet janë ato që u janë lënë trashëgim institucioneve fetare ose shkollore, fondacioneve bamirëse.

187. Me daljen e Shqipërisë si një shtet i pavarur e sovran, të gjitha tokat mirie kthehen në toka mulk, d.m.th. në pronë private të plotë e të lirë.

188. Trashëgimi i të gjitha pronave të patundshme do të bëhet sipas dispozitave të ligjit lidhur me (tokat) mirie.

189. Leget e tokave të punueshme, të pyjeve, të kullotave, të livadheve, të vreshtave, të perimoreve në favor të institucioneve fetare ose shkollore, të organizatave mëshiruese dhe bamirëse myslimane (vakëfeve) janë të ndaluara. Leget në favor të personave juridikë, që u nënshtrohen ligjeve civile të vendit, janë të lira.

190. Të ardhurat e pasurive të kushtuara (vakëfeve) mund të sekuestrohen për borxhe, juridikisht të konstatuara, të institucioneve ose të komuniteteve, të cilave këto pasuri u përkasin. Për të siguruar të drejtat e tyre, kreditorët e këtyre komuniteteve ose institucioneve mund të kërkojnë nga gjykata civile vënien nën sekuestër të këtyre pasurive.

191. Çdo pronar, toka e të cilit është e ngarkuar me servitute të vendosura ligjërisht, për t'u liruar duhet t'i drejtohet gjykatës kompetente, e cila vendos për lirim dhe, po qe rasti, cakton edhe shumën, si dhe mënyrën e pagimit. Në qoftë se nga ky servitut përfiton një komunë që nuk ka arkë komunale të organizuar, shpërblimi i caktuar derdhet në Bankën Kombëtare, e cila u paguan kamatat vjetore personave që kanë të drejtë. Kapitali nuk mund të preket e të përdoret veçse me autorizim të posaçëm të qeverisë.

192. Hipotekimi i pronave tokësore është i lejuar. Një ligj i veçantë do të rregullojë hollësisht dhe kushtet.

193. Neni 33 parashikon dhe rregullon kushtet dhe rastet e shpronësimit.

194. Qeveria duhet të hartojë sa më shpejt dy projektligje, njërin për krijimin e një kadastrë të pronave tokësore, që ndodhen brënda kufijve të principatës, tjetrin për ndryshimin e organizimit të vakëfeve.

Kapitulli XIV

Bujqësia, tregtia, industria

195. Departamenti i bujqësisë, i tregtisë dhe i industrisë ndahet në dy seksione: a) bujqësia, b) tregtia, industria, lundrimi; që do të kenë secili nga një shef seksioni në krye.

a) Bujqësia

196. Seksioni i bujqësisë do të përfshijë, veç shefit të tij, një inxhinier agronom, një inspektor të përgjithshëm të pyjeve dhe një drejtor të kadastrës. Këta nëpunës përbëjnë bashkërisht këshillin e përhershëm të seksionit.

197. Seksioni i bujqësisë ka për detyrë të studiojë masat që mund të mbrojnë, të nxisin dhe të zhvillojnë bujqësinë në të gjitha degët e saj, pyllëzimin e vendit dhe

përmirësimin e racës së kafshëve shtëpiake. Ai duhet të kujdeset për krijimin e fermave model dhe të qëndrave të ndërimit.

198. Derisa departamenti i bujqësisë të ketë përpunuar dispozitat përkatëse, ligjet dhe rregulloret që janë tani në fuqi në Perandorinë Osmane lidhur me zbulimin, dhënien në koncesion dhe shfrytëzimin e minierave, do të vazhdojnë të mbahen në fuqi në Shqipëri. Të drejtat e koncesioneve dhe lejet e kërkimeve që janë dhënë në përputhje me ligjet ekzistuese, gjatë regjimit të mëparshëm, duhet të respektohen e të mbahen nga shteti i ri.

199. Edhe ligjet e urdhëresat osmane që kanë të bëjnë me pyjet do të qëndrojnë gjithashtu në fuqi deri në një urdhër të dytë. Inspektori i përgjithshëm i pyjeve ngarkohet me zbatimin e tyre.

b) Tregtia, industria, lundrimi

200. Ushtrimi i veprimtarive në fushën e tregtisë, të industrisë, si dhe ushtrimi i zejeve është i lirë.

201. Për hapjen e fabrikave dhe të uzinave duhet marrë më parë leja e autoriteteve kompetente, sipas rregulloreve që do të nxjerrë për këtë qëllim seksioni i tregtisë.

202. Shteti nuk mund të vendosë monopole, të cilat mund të cënonin detyrimet ekzistuese.

203. Me autorizimin e ministrit kompetent do të krijohen dhoma tregtie e industrie. Çdo tregtar që paguan taksën e fitimit mund të regjistrohet si anëtar i dhomës së tregtisë. Kjo e fundit do të zgjedhë një komitet administrues, i cili nga ana e tij, do të zgjedhë një kryetar.

204. Dhomat e tregtisë të krijuara në këtë mënyrë, do të përfaqësojnë interesat e tregtarëve dhe do të shtrohet çështja e hartimit të projektligjeve lidhur me tregtinë dhe me industrinë, si dhe në çdo rast tjetër që mund të prekë interesat e tregtisë.

205. Lundrimi në portet dhe në ujrat territoriale shqiptare është i lirë për anijet e të gjitha shtetësive në përputhje me traktatet dhe marrëveshjet ekzistuese.

206. Çdo anije e flotës tregtare shqiptare duhet të shënohet në regjistrat që duhet të mbahen në portet e caktuara nga qeveria shqiptare.

207. Dispozita të posaçme që duhet të nxirren nga ministria, do të rregullojnë çështjet e matjes së kapacitetit të anijeve, të kualifikimit të kapitenëve, timonierëve dhe të makinistëve, si dhe të shërbimit të porteve.

208. Qeveria shqiptare do të caktojë, po ta gjykojë të udhës, një flamur të veçantë për flotën tregtare.

Kapitulli XV

Posta, telegrafi, telefoni

209. Departamenti i postës dhe i telegrafit ndahet në dy seksione: a) posta, b) telegrafi dhe telefoni, që do të kenë secili një shef seksioni në krye.

210. Për sa i përket administrimit të postës dhe të telegrafit në të gjitha pjesët e principatës, ai do të jetë në duart e qeverisë shqiptare, por se kjo do të respektojë të drejtat e fituara qysh më parë. Për sa i përket shërbimit telefonik, qeveria, po ta shohë të volitshme, mund t'ia japë si koncesion industrisë private.

Kapitulli XVI

Marrëdhëniet e jashtme

211. Kryetari i Këshillit të Ministrave, në cilësinë e tij si Ministër i Punëve të Jashtme, shërben si ndërmjetës midis sovranit dhe përfaqësuesve të huaj të akredituar pranë tij; ai merr masat e nevojshme për të siguruar agremanin për ministrat (fuqiplotë) si dhe për t'u lëshuar ekzekuaturat konsujve të vendeve të huaja.

Ai i paraqet sovranit për miratim emrat e përfaqësuesve diplomatikë e konsullorë që janë për t'u emëruar për jashtë shtetit.

212. Nëpunësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme mund të vihen në dispozicion pa gjykim dhe pa dhënë arësytet e një mase të tillë.

Kapitulli XVII

Konfliktet administrative

213. Për konfliktet administrative do të krijohen gjykata të posaçme. Ata do të shqyrtojnë ankesat e personave qoftë fizikë apo juridikë kundër veprimeve dhe mosveprimeve të organeve administrative për të vënë në vend një të drejtë të fituar.

Veç asaj, një ligj i veçantë do të përmbajë çështjet që do t'u jepen për shqyrtim këtyre gjykatave. Po ky ligj do të rregullojë procedurën dhe do të caktojë afatet e apelimit.

214. Një gjykatë e instancës së parë do të ngrihet në kryeqendrën e çdo sanxhaku. Kryetari i saj do të zgjidhet nga princi midis gjyqtarëve të gjykatave të zakonshme të instancës...